

Parlament
Detyrat para vizitës së Junkerit

Fq.4



AMBASADORI YLBER HYSA
Të konkretizohet autostradën deri në Bllacë

Fq.7



Shkupi i gatshëm për Shkëndijën

Fq.19



Koha

www.koha.mk



10 VJET SHTET

Fq.16

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3295 · e shtunë/e diel 17-18 shkurt, 2018

-2°C | 11°C

15 DEN

AKTUALE

I jepet lamtumira e fundit Abdilaqim Ademit



Në moshën 49 vjeçare ka ndërruar jetë të enjten mbrëma Abdilaqim Ademi, funksionarë i lart i Bashkimit Demokratik për Integrim. Ai, të premten në mesditë është varrosur me nderime fetare në varrezat në fshatin Shemshovë në vendlindjen e tij. Në ceremoninë e...

Fq.9

RAJON

Arrihet ujdia për demarkacionin

Fq.17

GLOBI

BE qorton Facebook dhe Twitter

Fq.15

FORUM

Maqedonia dhe shqiptarët

Fq.10



PARADOKSET E PROGRAMIT VJETOR

PËR SHEFIN E KABINETIT, 660 MIJË DENARË



Edhe pse Valmir Aziri thotë se nuk është në dijeni se mes projekteve të miratuara mund të ketë raste me konflikte interesash, në mesin e fituesve të mjeteve është edhe shefi i Kabinetit të tij, Arlind Huseni me 660 mijë denarë. Ekspertët thonë se ka indikacione për korrupsion dhe ftojnë Prokurorinë të hetojë keqpërdorimet eventuale

Fq.3

Çdo i dyti i papunë

Shkup, 15 shkurt - Çdo i dyti i ri në Maqedoni dhe Greqi është i papunë, çdo i treti në Kosovë dhe çdo i katërti i ri në Kroaci. Analizat tregojnë se në vitin 2016, Bosnja dhe Hercegovina ka qenë e para në rajon me 76.6 të të rinjve të papunë, ndërsa në vendin e dytë me gjysmën e të rinjve të papunë renditet Maqedonia. "Të rinjtë në Maqedoni që nuk kanë punë ballafaqohen me periudha të gjata të kërkesës për

punësim. Pjesëmarrja e të rinjve të papunë të moshës 15 deri 29 vjeç, që kërkojnë punë më shumë se një vjet është 34.2 për qind e numrit të përgjithshëm të të papunëve për një periudhë afatgjate në vitin 2016" thuhet në analizën e Entit të Statistikës. Njohësit e kësaj problematike thonë se papunësia e të rinjve akoma paraqet problem të madh dhe sfidë për shoqërinë tonë, që kërkojnë...

Fq.6



EDITORIAL

**(JO)VENDIMARRJA
QYTETARE**

Emin AZEMI

Një demokraci e konsoliduar nuk është e ngritur vetëm mbi institucione kredibile dhe parime që garantojnë votën e lirë. Përtej kësaj, demokracitë liberale në Perëndim ka kohë që promovojnë edhe një formë tjetër të hapjes së institucioneve ndaj mendimeve alternative, duke përfshi pjesëmarrjen e vet qytetarëve në vendimarrje.

Këtyre ditëve edhe Instituti për demokraci "Societas Civilis" nga Shkupi dhe Qendra për analiza ekonomike (CEA) ka zhvilluar një hulumtim të mendimit publik lidhur me qëndrimet dhe besueshmërinë e qytetarëve ndaj institucioneve, si dhe perceptimi rreth administrimit, cilësia e legjislatives dhe siguria juridike. Gjetjet e këtij hulumtimi do të shërbejnë për një orientim më preciz të aktiviteteve në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e përgatitjes së ligjeve dhe politikave.

Nga qytetarët e anketuar, del që 77 për qind e tyre as që kanë dëgjuar për një instrument të tillë që mundëson pjesëmarrjen e tyre. Madje edhe 72 për qind e atyre që thanë se punojnë në administratën shtetërore, as kishin dëgjuar për instrumentin e njëjtë. Nga ky hulumtim rezultojnë që publiku i gjerë është i përgatitur nga sfera e debatit dhe konsultimeve para ndryshimeve të ligjeve dhe akteve të ndryshme normative. Zakonisht konsultime të tilla sipërfaqësore mbahen me disa grupe të caktuara të interesit, kryesisht nga fusha e biznesit, duke lënë anash organizimet qytetare. Qytetarët në Maqedoni nuk e kanë luksin të jenë palë konsultuese gjatë përgatitjes së ligjeve me interes publik, sikundër që ndodhë gjithkund në Evropë ku ekziston një aktivitet i gjallë lobues i shoqërisë civile në dizajnimin e projekteve e ligjeve të rëndësishme.

Përfshirja e publikut në përgatitjen dhe planifikimin e legjislatives, përmes përfqësimeve profesionale është një lehtësim edhe për vetë deputetët dhe anëtarët e qeverisë. Por edhe një shkarkim i debatit politik midis palëve konfrontuese, me qëllim të sjelljes së frymës pajtuese për projekte që kanë interes të përbashkët publik. Krejt kjo dhe teknikisht është e mundur nëse institucionet shtetërore në faqet e tyre elektronike i publikojnë projekt-propozimet ligjore, ku qytetarët do të kishin mundësi t'i komentojnë ndryshimet e propozuara ligjore dhe me këtë i pamundësohet shumicës parlamentare dhe Qeverisë që me procedurë të shpejt të miratojnë ligje me procedurë të shpejtuar.

Nëse opozita është konsideruar me të drejtë si pushteti moral i një shoqërie, atëherë do të duhej të presim që ky pushtet të ketë një bazë edhe më të gjerë, duke inkorporuar faktorë jashtëpolitik, grupime profesionale dhe lëvizje të ndryshme qytetare. Por defekti i veprimtimit opozitar te ne vuan pasojat e mendimit bardh-zj, ku kundërshtari projektohet vetëm në një adresë, e cila duhet zëvendësuar nesër me një performancë tjetër politike, por pa sjell frymë ndryshimi në gjithë shoqërinë.

Gazeta KOHA**"konfiskohet" në Kërçovë**

Shkup, 16 shkurt - Një blerës anonim, që në orët e hershme të mëngjesit ka grumbulluar (blerë) të gjitha numrat e sotëm të gazetës KOHA, pas shkrimit në ballinë me titull "ART TETOVË, shoqata fantazmë që merr mbi 2.4 milionë", shkrim në të cilin bëhet fjalë për Shoqatën e Artistëve Shqiptarë - Art Tetovë, ndërsa ka fituar tre projekte me shifra të mëdha financiare nga Programi vjetor i Ministrisë së Kulturës. Bëhet fjalë për shoqatën Art Tetovë, me themelues personin Kujtim Saliu nga Kërçova, ndërsa me seli në një banesë në rrugën "180" në Tetovë, por që nuk ka ndonjë shënim apo diçka të ngjashme se në këtë banesë, zhvillohen aktivitete kulturore. Qytetarë të shumtë të Kërçovës, të habitur me mungesën e gazetës KOHA, kanë marrë përgjigje nga kiosqet e qytetit se një person, që herët në mëngjes ka grumbulluar gazetën, ndërsa nuk ka dhënë sqarime se për çfarë, mijëra gazeta të sotme të KOHËS i blen apo edhe se ku do t'i çojë! "Dikush ka porositur që skandali me qytetarin e Kërçovës që ka marrë 2.4 milionë denarë për tre projekte dhe me shoqatë famoze, të mos përhapet edhe në Kërçovë. Megjithatë, e dimë se kush qëndron mbrapa këtij skandali...", thonë disa qytetarë të Kërçovës.

"IDEJA" E FATMIR LIMAJT

"Idenë e Fatmir Limajt për Demarkacionin po e përkrahin ndërkombëtarët", shkruajnë portalet! Normalisht se ndërkombëtarët përkrahin ratifikimin e Marrëveshjes për Demarkacionin e që është varianti i qeverisë së Isa Mustafës. Ideja e tashme e Fatmir Limajt është ideja e Hashim Thaçit dhe Isa Mustafës. Idenë e Ramushit, të Fatmirit dhe të Albinut ne e kemi parë me kohë dhe ajo ka qenë që ky variant i Murat Mehës për Demarkacionin të mos kalojë në asnjë mënyrë. Qeveria Haradinaj madje ka shkarkuar Komisionin Meha dhe ka emëruar komisionin e ri qeveritar në krye me "disidentin" e LDK-së folk-patriotin Shpejtim Buliqi për ta hartuar versionin e ri. Ai version nuk kalon. Tash për çfarë ideje bëhet fjalë? Për idenë e vesë të b...a. Si ide mund të qëndrojë vetëm me qëllim të arritjes se unitetit politik për ratifikim të këtij dokumenti e të cilin e përkrah çdo njeri normal që ia don të mirën Kosovës. E përkrah edhe bashkësia ndërkombëtare. Por, përtej të qenit ide unifikimi, kjo është taktikë e pehllivanizmit politik për të ndejtë në pushtet dhe për t'i ikur ndëshkimit. Populli nuk duhet t'i shpërblejë mashtruesit. Ai duhet t'i ndëshkojë ata", shkruan në profilin tij në FB, mjeku dhe shkrimtari, Liri Loshi.

**TERRORI I PAPANË IDENTITAR**

"Shqiptarët e Kosovës janë duke ju nënshtruar një terrori të paparë identitar, padrejtësisht dhe pa asnjë nevojë. Shteti i Kosovës dhe disa liderë të tij duhet të sillen me mençuri. Mosrespektimi i vullnetit të shumicës absolute të popullit të Kosovës dhe zëvendësimi i flamurit kuqezi me flamurin shtetëror janë kundër shqiptarëve dhe kundër Kosovës. Flamuri shtetëror i Kosovës është i Kosovës dhe mjet i rrethanave, por nuk duhet të përdoret si armë lufte kundër flamurit kuqezi të të gjithë shqiptarëve. Kryeministri aktual Ramush Haradinaj duhet të tregojë a do të jetë Helmut Kohl apo Erich Honecker, Abraham Lincoln apo Jefferson Davis. Jam i bindur që vëllezërit e Ramush Haradinajt, të vranë nga pushtuesit në luftimin për lirinë e popullit të Kosovës të ushtrorë lirshëm vullnetin, nuk do të dëshironin vëllain e tyre me pushtet të bëhet as si Honeckeri e aq më pak si Davisi. Kosova duhet t'u kthehet problemeve reale-- hajnisë dhe korrupsionit të pushtetarëve, varfërisë turpëruese, mungesës sistematike të kujdesit shëndetësor, nivelit katastrofal të arsimit, zhatjeve financiare dhe hipokrizisë moralo-etike të banditëve të të ashtuquajturës shoqëri civile dhe gjithësi ofrimit të zgjidhjeve për zhvillim ekonomik. Se cili është identiteti i shqiptarëve e dinë vetë shqiptarët!", ka shkruar në FB, veprimtari shqiptaro-amerikan, Uk Lushi.

**7 DITË, E PAMJA PËR ÇAKORR E ZHLEB**

"7 dite, e pamja për Çakorr e Zhleb ne Zyrë të Kryeministrit. Pal Lekaj po i shkepke çajat e sokat. Halil Matoshi po i palojke kepuat në korridor. Jemi mërzit. Ama, ta mbajna veten pak. Qoftë shnosh pjesa tjetër e Kosoves se Çakorri e Zhlebi shkuan në botën tjetër. Kush është për me u nis për me pa Çakorrin, për herë të fundit? Me i ra për fytyrë, me u përshëndet me ta. Negociatat e grupeve punuese Kosovë-Mali i Zi do të marrin kohë. Neve do të na marrë malli për me shku në Çakorr", shkruan në profilin e tij në FB, Parim Olluri.



MEDIACitate

Gazeta prestigjioze New York Times ka publikuar një artikull për historinë e Kosovës që prej fundit të luftës në vitin 1999 e deri në dhjetë vjetorin e Pavarësisë së Kosovës. Reporteri Andrew Testa në këtë artikull të NYT ka përshkruar Kosovën gjatë tërë 20 vjetëve sa ka qenë raportues për Kosovën. Ai shkruan se së paku një herë në vit viziton Kosovën dhe ka parë ndryshime të mëdha gjatë viteve të fundit. "Ka ndryshime te vendi dhe tek njerëzit. Kur u ktheva këtë dimër, u befasova sesi optimizmi i madh i kosovarëve ishte shndërruar në zhgënjim. Ata janë të pakënaqur edhe me korrupsionin që mbretëron", ka shkruar Testa për New York Times.

"Të betohem në Zot, po të mos ishte për ata që kanë dhënë jetën për këtë, unë do të thosha të kthehem si dikur", i ka thënë Testas një qytetar nga Kosova. "Atëherë kishim jetë më të mirë; kishim më shumë mundësi", ka thënë ai, duke mos dashur t'i përmendë emri shkaku i frikës për deklaratën që e konsideronte si jo patriotike. Reporteri i NYT ka shkruar edhe për vrasjen e politikanit serb, Oliver Ivanoviqit para selisë së partisë së tij në Mitrovicë. "Mitrovica mbetet qytet i ngrirë dhe i ndarë. Frika mbretëron në pjesën serbe. Një banor përshkruan policët atje si lulet, vetëm për dekorim", ka shkruar ai. New York Times gjithashtu ka shkruar për masakrat e kryera në Kosovë. Testa përmend masakrën e Mejës, në të cilën u vranë 372 burra e djem. "Disa trupa ende mungojnë. Disa janë gjetur nëpër varre masive në Serbi", ka shkruar Testa. Reporteri i New York Times ka vizituar edhe Gjakovën. Në këtë qytet është takuar me Nusrete Kumnovën dhe Ferdonije Qerkezin. Gjatë luftës djali i vetëm i Kumnovës ishte marrë nga forcat serbe dhe ende është i zhdukur, ndërsa Qerkezi ka humbur burrin dhe katër djemtë. Mbetjet e dy djemve të Qerkezit janë gjetur dhe varrosur. Burri i saj dhe dy djemtë tjerë ende mungojnë. "Për këto gra, koha nuk ecën. Qerkezi ka shndërruar shtëpinë në muze. Dhomat janë ashtu siç i kanë lënë ata", shkruan NYT. "Ajo refuzon të përgjigjet se si ndjehet për përvjetorin e pavarësisë së Kosovës, duke më thënë: 'Pah, mos më pyet!'".

(New York Times, 16 shkurt)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

Kush ishte Mustafa Pashë Bushatlliu?

Mustafa Pashë Bushatlliu (1796-1860) ishte sundimtari i fundit i dinastisë së Bushatllinjve, vazhdues, edhe pse me lëkundje, i luftës për autonomi të Pashallëkut të Shkodrës. Iu kundërvu aktivisht synimeve ekspansioniste franceze në bregdetin perëndimor të Ballkanit. Mori anën e Portës së Lartë për shembjen e pashallëkut të Janinës, i trembur nga prijet e Ali Pashë Tepelenës për të bashkuar nën

udhëheqjen e vet të gjitha trojet shqiptare në një shtet. Pas vrasjes së Ali Pashës, Mehmet Bushatlliu u drejtua kundër politikës centralizuese të Portës. Më 1830 veziri Bushatlliu u hodh në një kryengritje të hapur kundër sulltanit. Kjo kryengritje nuk arriti të përgjithësohej. Mehmet Bushatlliu u tërhoq në kalanë e Shkodrës dhe pas një rrethimi të gjatë u detyrua të dorëzohej dhe të braktiste vendin.

PARADOKSET E PROGRAMIT VJETOR TË MINISTRISË SË KULTURËS

PËR SHEFIN E KABINETIT, 660 MIJË DENARË



Edhe pse Valmir Aziri thotë se nuk është në dijeni se mes projekteve të miratuara mund të ketë raste me konflikte interesash, në mesin e fituesve të mjeteve është edhe shefi i Kabinetit të tij, Arlind Huseni me 660 mijë denarë. Ekspertët thonë se ka indikacione për korrupsion dhe ftojnë Prokurorinë të hetojë keqpërdorimet eventuale

REAGIMI I SHTËPISË
BOTUESE "VOKA 4"

Nënçmimi i letërsisë për fëmijë

Shtëpia botuese "VOKA 4" e themeluar në vitin 1993 është një ndër shtëpitë e para më prestigjioze e letërsisë për fëmijë në Maqedoni. Nga rezultatet e shpallura nga Ministria e Kulturës për veprimtari botuese, "VOKA 4" ka konkurruar me 10 libra dhe 3 revista mujore për fëmijë, ndërkaq nga kjo ministri u përkrahën tre libra me shuma qesharake - 50 dhe 60 mijë denarë dhe 3 revista nga 6 numra me nga 12 dhe 15 mijë denarë për numër. Si shtëpi botuese e shohim si të paarsyeshme këtë ndarje nënçmuese dhe tendencioze nga Komisioni për botime. Vetë fakti që revistat tona deri më tani kanë arritur tirazhin prej 2 milionësh, tregon faktin që ne jemi kampion të letërsisë për fëmijë në Maqedoni. E kjo, nënkupton që pakënaqësia jonë ndaj kësaj ndarje të padrejtë dhe tendencioze është në dëm të letërsisë për fëmijë dhe letërsisë shqiptare në përgjithësi. Duke pasur parasysh që prioritet i Ministrisë gjithmonë ka qenë përkrahja financiare botuesve dhe autorëve të dëshmuar, në ndarjen e shumtë të veprave të kaluara sivjet, mendojmë që është bërë një mospërfillje totale pikërisht ndaj botuesve dhe autorëve të mirëfilltë. Janë të përkrahura libra me shuma nga 150, 200 dhe 250 mijë denarë që ndoshta nuk kanë lidhje me letërsinë, ndërkaq maja e letërsisë për fëmijë - Agim Deva, përkrahet me një shumë qesharake me 50 mijë denarë. Ku është ndarja e drejtë dhe e mirëfilltë ndaj botuesve dhe autorëve të mirëfilltë në këtë lloj ndarjesh të padrejtë nga Ministria?! Shtëpia botuese "VOKA 4"

Koha Evis HALILI

Shkup, 16 shkurt - Në projektet e miratuara në Programin e këtij viti, sekretari shtetëror i Ministrisë së Kulturës, Vlamir Aziri mohon të ketë konflikte interesash dhe përzgjedhje preferenciale. Sipas tij, projektet janë vlerësuar në bazë të dokumentacioneve dhe nuk mund të paragjykojnë përpara se të realizohen. Por tabelat me paratë e ndara kanë tregues të tjerë. Mes atyre projekteve që dallohen dhe veçohen për shumata e mëdha, të cilat u janë besuar - janë edhe ato që janë fituar nga të punësuar brenda Ministrisë dhe kabinetit të sekretarit shtetëror. Një prej rasteve është ai i shoqatës "Ble-And" nga Tetova, në pronësi të pesë personave. Duke iu referuar të dhënave nga Regjistri Qendror, kjo shoqatë deklaroi si person të autorizuar Arlind Huseinin, i cili është shef në kabinetin e Hazirit. Edhe pse thotë se nuk është në dijeni se mes projekteve të miratuara mund të ketë raste me konflikte interesash, projektit konkurrues të "Ble-And" i janë dhënë 660 mijë denarë (në Manifestimet artistike) për realizimin e projektit për një festival folklorik për fëmijë. Kjo shumë është shumë herë më e madhe nga ajo që ndahet për manifestime të ngjashme (festivale për fëmijë), të cilat mbështeten me nga 80 mijë denarë. Ekziston apo jo konflikt interesash në këtë rast, si edhe në shumë të tjera në projektet fituese të Programit vjetor kryetarja e Transparent Maqedoni, Sllagjana Tasevska thotë se situata të tilla nuk duhen toleruar dhe nuk duhet të kalojnë pa pasoja, pasi bëhet fjalë për keqpërdorime të ndryshme, si tregtimi i influencës, keqpërdorimi i funksionit zyrtar, e të tjera.

"Në situata kur kemi konflikte interesash, ose kur dyshojmë për korrupsion dhe mosdeklarimin e rasteve që duhet të paraqiten, ky rast duhet të deklarohet. Sipas Ligjit për antikorrupsion, raste të tilla do të duhej të pa-



SLAGJANA TASEVA

Prokuroria publike duhet të merret me këto çështje që kanë të bëjnë me tregtimin e influencës. Dhe të mos flasim për dyshimin për mundësinë e tregtimit të influencës, fillimisht me keqpërdorime sa i takon funksionit zyrtar.

raqueshin. Ne flasim shumë pak për tregtimin me ndikimin, një gjë e tillë bëhet jo nga funksionarët, por nga ato që janë afër tyre, që të arrihen përfitime prej tyre, nga të tjerë, direkt dhe indirekt. Këtu ngrihen shumë çështje për të cilat duhet që Ministria të japë shpjegim dhe pas gjithë këtyre ngjarjeve - duhet të mendohet seriozisht edhe për integritetin e vetë ministrit lidhur me gjithë këto gjëra që janë diskutuar deri tani, për konflikt interesash, koncentrimin e mjeteve në kompani të caktuara... Pra, situata të tilla nuk duhen toleruar dhe nuk duhet të kalojnë pa pasoja", thotë Sllagjana Tasevska. Duke folur për projektet e miratuara, Tasevska thotë se ka pasur raste kur disa subjekteve i janë miratuar disa projekte në shumata të tilla që i tejkalojnë ato me të cilat mbështetet ajo që quhet "kultura elitare".

"Bëhet fjalë për tërheqje serioze të parave nga buxheti, duke keqpërdorur të gjitha procedurat për konkurse. Me të vërtetë nuk jam dakord me qëndrimin se kështu ka qenë programi dhe procedura. Duhej të kishte kapacitete për të korrigjuar atë që nuk ishte si duhet dhe jo të vazhdohet në të njëjtën mënyrë dhe të shkohet më larg. Për këtë rast duhet të jepet llogari dhe të gjitha ato dokumente duhet



VALMIR AZIRI

Sekretari shtetëror Valmir Aziri mohon të ketë konflikte interesash dhe përzgjedhje preferenciale. Sipas tij, projektet janë vlerësuar në bazë të dokumentacioneve dhe nuk mund të paragjykojnë përpara se të realizohen.

të vihen përpara opinionit. Prokuroria publike duhet të merret me këto çështje që kanë të bëjnë me tregtimin e influencës. Dhe të mos flasim për dyshimin për mundësinë e tregtimit të influencës, fillimisht me keqpërdorime sa i takon funksionit zyrtar. Prokurorët publikë absolutisht e them se kanë me çfarë të merren", thotë Tasevska. Në një prononcim të dhënë nga Aziri për gazetën KOHA lidhur me shumata e ndara për projekte në sektorë si muzikë, manifestime, dramë, e të tjera për të cilat ka pasur vërejtje nga vetë aplikuesit, por edhe nga anëtarët e komisioneve për formën e zhdrejtë dhe të pamerituar në ndarjen e të hollave, ai thotë se nuk është në atë pozicion për të plotësuar dëshirat dhe hatërmbetjet që i quan individuale dhe mohon se ka pasur përzgjedhje selektive. Por vërejtjet që nuk lidhen me projektet e miratuara, por me mënyrat sesi janë ndarë të hollat - kanë qenë arsye kryesore që anëtari i komisionit të Muzikës, Rami Mustafa, të mos jepte nënshkrimin e vet në listën finale me projektet fituese, pasi janë shpërfillur vlerësimet profesionale. Ai në një prononcim për gazetën KOHA thotë se qëndrimi i tij është kundër listës dhe shumave të ndara për projektet.



RAMI MUSTAFA

Nuk është respektuar vlerësimi im profesional. Këto rezultate nuk janë mbajne nënshkrimin tim dhe për këtë kam vënë në dijeni sekretarin

"Nuk është respektuar vlerësimi im profesional. Këto rezultate nuk mbajne nënshkrimin tim dhe për këtë kam vënë në dijeni sekretarin", thotë Mustafa. Në këtë sektor shumë shoqata e individë kanë konkurruar duke marrë fonde të mëdha, të tjerë shumata disa herë më të vogla nga sa kanë kërkuar. Një ditë më parë edhe Ministria e Kulturës ka reaguar lidhur me këto çështje, përmes një apeli drejtuar opinionit publik ftojnë në denoncimin e rasteve abuzive.

"Në mënyrë të vendosur mbajmë qëndrim se nëse ka indikacione për parregullsi në procesin e aplikimit dhe vendimin, ose në qoftë se persona të caktuar apo subjekteve të përfshira të nepotizmit, korrupsionit, klientelizmit apo praktika të tjera të paligjshme, Ministria është e gatshme që menjëherë të rishikojë këto raste, dhe në qoftë se është gjetur përgjegjësi, do të kryejë procedura disiplinore dhe të tjera në përputhje me ligjin... Koha e veprimtarisë së paligjshme dhe jo-profesionale ka përfunduar dhe praktikat e të punuarit me përgjegjësi", thuhet në reagimin e Ministrisë.

Në numrin e ardhshëm lexoni:
Kush nga "akrabatë" e sekretarëshes së Valmir Azirit ka fituar mjete nga Ministria e Kulturës?

PAS TË HËNËS MUND TË DIHEN REZULTATE GRUPEVE PUNUESE



Sipas informatave jozyrtare, në grupet punues përfaqësuesit e LSDM-së dhe VMRO-së merret vesh se kanë rënë dakord për ndryshimin e ligjeve që kërkojnë 2/3 e votave në Parlament, por dhe ligjeve që kërkohet shumicë absolute prej 61 votash

DETYRAT PARA VIZITËS SË JUNKERIT

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 16 shkurt - Deri më 25 shkurt, ditën kur Shkupin do ta vizitojë presidenti i Komisionit Evropian, Zhan Klod Junker, pritet që pushteti dhe opozita të arrijnë marrëveshje për kthimin e kësaj të fundit në Parlament dhe për-rahje e një sërë ligjesh që prekin reformat në sektorin e gjyqësisë dhe në atë të sigurisë nacionale. Mes tjerash, gjasat janë që pushteti dhe opozita të merren vesh edhe për Ligjin për gjuhët, por jo edhe të dihet publikisht i gjithë skenari rreth mbylljes së kësaj çështje që po zvarritet me muaj të tërë. Sipas informative jozyrtare, në grupet punues përfaqësuesit e LSDM-së dhe VMRO-së merret vesh se kanë rënë dakord për ndryshimin e ligjeve që kërkojnë 2/3 e votave në Parlament, por dhe ligjeve që kërkohet shumicë absolute prej 61 votash, siç janë Ligji për gjykatat, Ligji për organizmin e Prokurorisë publike, Ligji për Prokurorinë publike speciale, Ligji për Këshillin Gjyqësor dhe ai për Këshillin Prokurorial, Ligji për Ndjekje të Komunikimeve, Ligji për Policinë, Ligji për Avokatin e Popullit, Ligji për Agjencinë Teknike-Operative, Ligjin për Informatorët.

Po sipas këtyre burimeve, thuhet se LSDM dhe VMRO kanë biseduar gjerësisht edhe për ndryshimet në Kodin Zgjedhor, ndërsa kanë propozuar edhe atë që anëtarët e këtij institucioni të lartë të zgjidhen me short nga ana e gjykatësve të Gjykatës Supreme dhe një pjesë nga Gjykata administrative, por me përfaqësimin adekuat etnik. Për këtë dhe për idenë e shumë diskutuar që Maqedonia të kalojë në një zgjedhore, do të vijin në tavolinë pasi të mbarojnë puna me ligjet reformuese e cekura më lart. Siç paralajmëroi edhe zëvendëskrye-

ministri Bujar Osmani, partitë shqiptare mund të kyçen në fund të këtij dialogu mes LSDM-së dhe VMRO-së, por pa e precizuar deri në detaje se çdo të ndodh me Ligjin për gjuhën. Nga ana tjetër, për raportimet e gazetës KOHA dy javë më parë se ka shumë gjasa 35 mijë amendamentet e VMRO-së të përmblihen në më pak amendamente, së fundmi kanë folur edhe eksponentë të lartë nga BDI në disa media, por në kushte anonimiteti. Debat do të ketë para votimit të këtij Ligji, por siç theksojnë në BDI, ai debat nuk do të zgjatë shumë dhe nuk do të përfshijë të gjitha 35 mijë e 569 amendamentet e VMRO-së. Parlamenti i Republikës së Maqedonisë po harton Strategji të re dhe për një kohë të shkurtër do ta vë në funksion", thonë burime partiake. Të njëjtat burime zbulojnë se grupi parlamentar i LSDM-së ka marrë urdhër partiak që nga dita e hënë prania e tyre në Parlament është e obligueshme dhe e patjetërsueshme, por siç thonë, ende nuk e dinë se cila seancë parlamentare do të jetë në rend dite. Lidhur me amendamentet, zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska ka folur në një intervistë për TV24.

"Amendamentet që do të mbeten në 'lojë', do të grupohen, dhe në këtë mënyrë do të shkurohet edhe debati parlamentar

mbi to. Vlerësoj se pjesa më e madhe e amendamenteve që i ka parashtruar opozita për Ligjin e gjuhëve nuk janë amendamente të cilat mund të shqyrtohen në këtë fazë. Ne nuk duam që ta bëjmë të njëjtin gabim në të cilin Qeveria do ta diktojë tempon e vendimeve të Parlamentit, por presim që në një afat sa më të shkurtër të gjendet një zgjidhje dhe Parlamenti të vendoset në funksion", ka thënë Shekerinska. Me interes do të priten reagimet e VMRO-së, por pritet janë se nuk do të problematizohet kjo çështje për shkak të agjendës reformuese të vendit dhe bisedimeve të ndjeshme rreth çështjes së emrit me Greqinë. Kjo, pasi pushteti dhe opozita kanë shumë detyra për të bërë rreth implementimit të pikave të Strategjisë së Bashkimit Evropian për zgjerimin e këtij institucioni në Ballkanin Perëndimor. Përforcimi i mbështetjes për sundim të Ligjit, përforcimi i angazhimit për siguri dhe migracion, mbështetja e zhvillimit socio-ekonomik, rritja e lidhjeve të Maqedonisë, përfshirja në agjendën digjitale në Ballkan dhe mbështetja për pajtim dhe raporte të mira ndërfaqësore janë gjashtë pikat kyçe që iu parashtruan Maqedonisë në Strategjinë e Zgjerimit të Komisionit Evropian për prosperim në procesin eurointegruar.

Në lidhje me harmonizimin e legjislaturës së Maqedonisë me atë të Bashkimit Evropian, bëhet fjalë edhe përfshirje e misioneve këshilluese në fushën e sundimit të Ligjit me ekspertë ndërkombëtar; monitorim i reformave; monitorim i rasteve gjyqësore; vlerësim i punës së gjyqësorit; kahëzim i hapërimit të Maqedonisë nëpërmjet reformave në gjyqësor; pavarësi mediale dhe pluralizëm në shoqëri. Në vazhden e aktiviteteve eurointegruar, më 25 shkurt përfaqësuesi i Komisionit Evropian, Zhan Klod Junker vjen në Shkup për të nisur vizitën e tij rajonale në vendet e Ballkanit Perëndimor. Më 17 prill do të publikohet Raporti i rregullt i Strategjisë për zgjerim i Komisionit Evropian dhe raportet e tij për secilin shtet veçmas, më 17 maj mbahet Samiti i Këshillit Evropian për Ballkanin Perëndimor në Sofje të Bullgarisë, më qershor realizohen takime të Këshillit të përgjithshëm të BE-së dhe Këshillit Evropian me konkluzione të rëndësishme, në korrik kryesimin me BE-në e merr Austria, në korrik zhvillohet samiti i Londrës aktivitet ky që realizohet në kuadër të procesit të Berlinit dhe deri në fund të vitit 2018 zhvillohet debat i thellë me të gjitha vendet anëtare për ardhmërinë e Bashkimit Evropian edhe pas vitit 2025.

DIMITROVI PRET DATË GJATË KRYEMISIMIT BULLGAR ME KE-në

Ministri i Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov, theksoi të premten se pret që gjatë kryesimit të Bullgarisë me Këshillin e Bashkimit Evropian, Maqedonia të marrë datë për fillimin e negociatave për anëtarësim. "Bëjmë gjithçka që mundemi që në qershor të ketë vendim dhe bëjmë gjithçka që mundemi për ta bindur Greqinë që të jetë pjesë e atij konsensusi për Maqedoninë. Kjo do të



jetë një punë e mirë për Maqedoninë, për Bullgarinë, për të gjithë fqinjëve tanë, për Ballkanin, por edhe për Evropën", deklaroi shefi i diplomacisë së Maqedonisë, Nikolla Dimitrov, para fillimit të sesionit të së premtes gjatë të pjesës së dytë të takimit joformal të ministrave të punëve të jashtme të BE-së, Gimnih, që mbahet në Sofje.

Akademia greke mbështet emër me ndryshim të Kushtetutës

Athinë, 16 shkurt - Akademia greke e shkencave dhe arteve përmes kumtesës i komenton bisedat për emrin mes Maqedonisë dhe Greqisë, duke cekur se nevojitet marrëveshje sepse është në interes të të dy vendeve, por si parakusht përmend ndryshime kushtetuese. Në kumtesën e publikuar nga mediet greke, Akademia në vend të referencës së përkohshme IRJM, për vendin tonë e shfrytëzon frazën "shteti i Shkupit", lajmëron korrespondenti i MIA-s nga Athina. "Akademia vëren se parakusht i domosdoshëm për çfarëdo lloj marrëveshje për emrin e shtetit të Shkupit duhet të jetë ndryshimi i Kushtetutës, braktisja e kërkesave irredentiste (libra mësimor, harta gjeografike, përmendore të Aleksandrit të Madh etj.) dhe përvetësimi të historisë, kulturës dhe simboleve të vendit tonë. Vendbanimi i një populli nuk e cakton identitetin e tyre. Zvarritja e çështjes së pazgjidhur nuk është në interes të të dy vendeve", ceket në kumtesën që e transmetojnë mediet greke dhe e komentojnë si një ndër reagimet dhe rastet e rralla kur Akademia merr qëndrim.

Han i sigurt se emri do të zgjidhet deri në korrik



Sofje, 16 shkurt - Bashkimi Evropian është "plotësisht i sigurt" se Maqedonia do ta zgjidhë kontestin shumëvjeçar për emrin me Greqinë para korrikut, deklaroi në Sofje eurokomisari për zgjerim dhe fqinjësi të mirë Johanas Han. I pyetur nëse kontesti do të zgjidhet deri në fund të kryesimit bullgar, që përfundon në qershor, han u përgjigj se është "plotësisht i sigurt për këtë". Ai dje në Sofje mori pjesë në takimin e ministrave të punëve të jashtme të vendeve të BE-së dhe vendet candidate. Pritet se kontesti për emrin do të zgjidhet dhe Maqedonia gjatë kryesimit bullgar do të marrë datë për fillimin e negociatave me BE-në, tha edhe ministrja bullgare Punëve të Jashtme Ekaterina Zaharieva. Ajo shpreson se në takimin e Këshillit Evropian në qershor do të merret vendim për hapjen e negociatave me Maqedoninë. "Duke e marrë parasysh zhvillimin e ngjarjeve dhe bisedimeve të cilat janë në vijim, mendoj se ka shans të madh kjo të ndodhë", tha Zaharieva në konferencë për shtyp pas takimit në Sofje. Për kontestin midis Shkupit dhe Athinës për emrin, Zaharieva tha se shih vullnet politik te qeveritë e të dy vendeve për gjetjen e zgjidhjes së përhershme.

PROLONGIMI I SEANCAVE TË PSP-së DERI NË PAFUNDËSI

Lëshimet e qëllimta ose jo të palës mbrojtëse, gjykatësja Dobrilla Kacarska, nuk i ka komentuar, megjithëse avokatëve të të akuzuarit Nikolla Gruevski, Gordana Jankullovska dhe Gjoko Popovski, ju dha mundësinë prej gjysme orë t'i shqyrtojnë të njëjtat

GRUEVSKI DËSHIRON TË ZVARRIT SEANCAT

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 16 shkurt - Ish kryeministri Nikolla Gruevski dhe ekipi i avokatëve që e mbron atë dhe të akuzuarit tjerë në rastet e Prokurorisë Speciale Publike, si duket nuk është interesuar të fillojnë me procedimin e lëndëve gjyqësore kundër tyre. Kundërshtimet e vazhdueshme se gjoja nuk janë plotësuar kushtet për fillimin e proceseve gjyqësor kundër tyre, kanë vazhduar edhe të premtën për rastin "Tank". Kësaj radhe, arsyetimi i palës mbrojtëse ishte se ju duhet më tepër kohë për t'i shqyrtuar dhe analizuar procesverbalet e seancës së kaluar. Kryetarja e Trupit gjykues, Dobrilla Kacarska, ndaj këtyre vërejtjeve sqaroi se afati ligjor për përgatitjen e procesverbale të shkruara dhe atyre të xhiruara (në CD), është respektuar. Mes tjerash, kjo gjykatëse nënvizoi se avokatët nga ana e saj kanë qenë të njoftuar se procesverbalet janë gati me kohë, megjithatë për disa ditë me radhë të njëjtit nuk janë paraqitur në Gjykatë për t'i marrë. Ky lloj i lajmërimit të avokatëve, siç tha gjykatësja Kacarska, nuk është obligim ligjor i saj, por se këtë e ka bërë nga vullneti i mirë. Përfaqësuesit e PSP-së, sipas gjykatës në rastin "Tank", kanë qenë pala të cilat janë paraqitur në Gjykatë dhe i kanë marrë të dy llojet e procesverbaleve. Lëshimet e qëllimta ose jo të palës mbrojtëse, gjykatësja Dobrilla Kacarska, sa i përket ngritjes së procesverba-

leve për rastin "Tank", të premtën nuk i komentoi. Por avokatëve të të akuzuarve Nikolla Gruevski, Gordana Jankullovska dhe Gjoko Popovski, ju dha mundësinë prej gjysme orë t'i shqyrtojnë të njëjtat. Ofendimin se kjo është një "gjykatë partiake", të cilët i akuzuari Gruevski ia drejtoi gjykatës Kacarska, rezultoi me një vërejtje nga kjo e fundit, e cila paralajmëroi se edhe një ofendim i tillë dhe ajo do t'i zbatojë dispozitat e Ligjit për procedurë penale. Përplasjet dhe diskutimet e pazakonta mes të akuzuarve Nikolla Gruevski e Gordana Jankullovska me gjykatësen Dobrilla Kacarska me vëmendje i ka përcjellë prokurorja speciale Lençe Ristovska, e cila e përsëritin qëndrimin e

njohur të PSP-së se, kërkesat e palës mbrojtëse për të mos filluar me procesin bëhet me të vetmin qëllim - zvarritjen e proceseve gjyqësore. "Njeriut me dhunë mundet t'i merret, por në asnjë mënyrë nuk mund t'i jepet. Avokatët e kishin të njohur se seanca e radhës për këtë lëndë do të mbahet sot dhe në këtë drejtim - ata kanë mundur t'i realizojnë të drejtat të cilat i kontestojnë. Një gjë e tillë gjatë këtyre ditëve nuk ka ndodhur dhe kjo kryekëput është lëshim i tyre. Kërkesat për pauzë janë të pakuptimta, në kohën kur të gjithë të pranishmit në sallë, në seancë e fundi e cila zgjat për më tepër se katër orë, ishin të njoftuar me të gjitha pyetjet dhe kërkesat", tha prokurorja Ristov-

ska. Ndryshe, në seancën gjyqësore të zhvilluar më 12 shkurt, pala mbrojtëse e të akuzuarve në këtë lëndë kërkoi që "bombat" e publikuara për blerjen e "mercedesit" të mos merren parasysh si dëshmi në rastin "Tank". Avokati i Gordana Jankullovska dhe Nikolla Gruevskit, Gjoko Popovski theskoi se katër nga gjithsej tetë "bomba" për blerjen e "mercedesit" në vlerë për 600 mijë euro, në vitin 2012, janë bërë publike dhe të njëjtat në këtë procedurë, vlerësojnë se janë siguruar në mënyrë të jashtëligjshme. Seanca e radhës për rastin "Tank" është paraparë të mbahet më datë 12 mars, kur edhe pritet të prezantohen dëshmitarët e propozuar nga PSP-ja.

PËR MË 2 MARS SHTYHET SEANCA GREKE PËR GRUEVSKIN DHE BOSHKOVSKIN

Për më 2 mars është shtyrë seanca pas ankesës së parashtruar deri te Gjykata Supreme në Athinë, për vendimin për ekstradimin e Goran Grujevskit dhe Nikolla Boshkovskit, siç lajmëroi korrespondenti i MIA-s nga Athina, është periudha e shkurtër që e kanë pasur avokatët për shqyrtimin e lëndës dhe sepse nuk është siguruar përkthyes në gjuhën maqedonase. Gjashtë gjykatës dhe prokurori, kompetentë për shqyrtimin e ankesës në Gjykatën Supreme greke, e dëgjuan arsyetimin e avokatëve dhe vendosën që seanca të shtyhet për 2 javë. Avokatët e Grujevskit dhe Boshkovskit, që në fillim kërkuan shtyrjen e seancës, ndërsa këtë e mbështetën me fakte se nuk kanë masur kohë të mjaftueshme ty shqyrtojnë lëndën dhe për shkak të mungesës së përkthyesit nga gjuha greke në atë maqedonase dhe anasjelltas. Njëri

nga avokatët tha se të hënën e ka marrë lëndën, ndërsa Grujevski dhe Boshkovski të martën nga Selaniku, janë sjellë në Athina, ku ai në ka pasur mundësi të bisedojë me ta, as kohë të mjaftueshme ta shqyrtojë lëndën. Gjykatësja konkludoi se nuk kanë pasur mundësi të përgatiten, ndërsa të dy avokatët kanë thënë se dëshirojnë që seanca të mbahet në mënyrën më të mirë të mundshme dhe u angazhuan se për herën e ardhshme do të sigurojnë përkthyes. Edhe Grujevski edhe Boshkovski në pyetjen e gjykatës nëse pajtohen me shtyrjen u përgjigjën në mënyrë pohuese. Siç lajmëroi korrespondenti i MIA-s nga Athina, Grujevski dhe Boshkovski në shoqërim të dy policëve mbërritën në sallën e gjykatës dhe me qetësi i kanë ndjekur të gjitha rastet që ishin para rastit të tyre.

KRONIKË

Një 40-vjeçarje i keqpërdorin profilin

40-vjeçarja me initiale nga Gostivari L.L ka denoncuar se një person i panjohur i ka keqpërdorur të dhënat personale duke krijuar një profil të rrejshëm në rrjetet sociale gjatë vitit 2016. Në profilin e rrejshëm ku ka qenë e vendosur edhe motra e saj, ndërsa janë vendosur edhe fotografi me përmbajtje të pahijshme, përmes emailit ka kontaktuar edhe me anëtarë të familjes. Punohet në zbardhjen e rastit.

Gruaja e martuar largohet nga shtëpia

32-vjeçari Xh,Sh nga fshati Çegran të enjten rreth orës 17 ka denoncuar se rreth orës 11 është larguar nga shtëpia bashkëshortja e tij R.D, 30-vjeçare, me të cilën ka qenë i martuar për pesë vite dhe kanë patur një fëmijë të vogël. E denoncuar me vete ka patur edhe dokumentet udhëtimi si dhe një celular. Policia po punon në gjetjen e 30-vjeçares.

Qent sulmojnë një 53-vjeçare

53 vjeçarja S.I nga fshati Leshkë i Komunës së Tearcës në orën 5 e 20 minuta të ditës së premtë ka denoncuar se duke lëvizur në rrugën regjionale Tetovë-Jazhincë në afërsi të një fabrike është sulmuar nga qen endacak. Gjatë sulmit, ajo ka marrë lëndime në shpinë dhe është dërguar në Spitalin Klinik të Tetovës për shërim. (U.H)

Nëpër rrugë vdiqën 155 persona

Shkup, 16 shkurt - Vitin e kaluar 155 njerëz e humbën jetën në fatkeqësi komunikacioni nëpër rrugët e vendit. Prej tyre 150 persona jetën e humbën në 3918 fatkeqësi të shkaktuara nga gabimi i vozitësit. Në 101 fatkeqësi, ndërkaq, pesë persona e humbën jetën për gabim të këmbësorit. Më së shumti të vdekur në fatkeqësi ka pasur në korrik të vitit të kaluar, dhe atë të shtunave, në periudhën prej 12 deri në orën 16. Sipas statistikës që e kumtoi MPB, në vitin 2017 në Maqedoni kanë ndodhur 4019 fatkeqësi, në të cilat ka pasur 6379 të pësuar. Shkak më i shpeshtë i fatkeqësive ishte vozitja e shpejtë, ndërsa më së shumti nga personat që pësuan janë të moshës prej 41 deri 65 vjeç. Kryeqyteti kryeson në listën ku vitin e kaluar ndodhën 1652 fatkeqësi komunikacioni në të cilat jetën e humbën 37 persona, ndërkaq pësuan gjithsej 2500 pjesëmarrës në komunikacion. Menjëherë pas Shkupit u gjend Shtipi, ku jetën e humbën 30 persona në 321 fatkeqësi. Për fat, në Berovë dhe Krushevë nuk pati të vdekur, por edhe atje ndodhën gjithsej 10 fatkeqësi komunikacioni. Dëmi i përgjithshëm material në të gjitha rrugët në Maqedoni paraqet rreth dy milionë euro.

ME RIKUALIFIKIM KUNDËR PUNËS NË TË ZEZË



Çdo i dyti i ri në Maqedoni dhe Greqi është i papunë, çdo i treti në Kosovë dhe çdo i katërti i ri në Kroaci është i papunë. Analizat tregojnë se në vitin 2016, Bosnja dhe Hercegovina ka qenë e para në rajon me 76.6 të të rinjve të papunë, ndërsa në vendin e dytë me gjysmën e të rinjve të papunë renditet Maqedonia

ÇDO I DYTI I PAPUNË

kërkojnë politika të reja inovative, që do të stimulojnë të rinjtë të vetëpunësohen dhe të nisin biznese të reja.

"Një nga masat në këtë drejtim është edhe rikualifikimi i një pjese të caktuar të kadrove që vështirë gjejnë punë, ulje e nivelit të personave që punojnë në të zeze si dhe vendosjen e sistemit të mësimi të përgjithshëm ngjashëm me shtetet e zhvilluara në kuadër të së cilin individët stimulohen të përsosin në fushat ku ka kërkesa më të mëdha për punë. Nevojitet edhe një analizë serioze e tregut të punës dhe profileve arsimore që nevojiten për të zvogëluar kohën që kalojnë të rinjtë duke pritur punë pas përfundimit të shkollimit të tyre", thotë ekspertja e kësaj fushe, Elena Mitreva.

Sipas saj ekzistojnë edhe mjaft programe interesante që ju ndihmojnë të rinjve më lehtë të kyçen në tregun e punës. Për shembull në Gjermani ekziston programi për orientim profesional që ju ndihmon të rinjve të zgjedhin karrierën e tyre në bazë të kurseve për orientim profesional si dhe përvojës së punës përmes programit të prak-

tikantëve. Në Holandë ekzistojnë kompanitë të dëshmuara shtetërore për "mësimin" e të rinjve që ofrojnë mundësi për mësim përmes praktikës. Në këtë mënyrë të rinjtë fitojnë përvojë pune dhe njëherazi janë të paguar për mundin e tyre. Të rinjtë fitojnë edhe shërbime intensive për orientimin profesional gjatë tranzicionit të tyre në tregun e punës. Në Austri, shërbimi nacional i punësimit është përgjegjës për të rinjtë e papunë dhe duhet tu ofrojë mësim të serishëm të kombinuar me punë praktike.

Në ndërkohë edhe analizat e Bankës Botërore, tregojnë se papunësia e madhe e të rinjve në shtetet e rajonit kufizon mundësitë për rritjen e standardeve të jetesës dhe rritjen ekonomike në periudhë afatmesme. Në analizën e saj, banka rendit edhe disa nga karakteristikat e papunësisë në rajon të të rinjtë.

Papunësia për të rinjtë në Evropën Juglindore është më shumë se dy herë më e lartë për të rinjtë, si për të rriturit, ndërsa femrat e reja kanë një lidhje të dobët me tregun e punës. Gjithashtu

humbësit më të mëdhenj të vendeve të punës gjatë dobësimit të ekonomisë janë të rinjtë, ndërsa ato janë edhe përfituesit më të vegjël kur kemi rritje të ekonomisë.

"Për Evropën Juglindore, një rënie prej 1 pikë përqindje në rritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto ka tendencë për të rritur shkallën e papunësisë e të rinjve me 0.83 e një pikë përqindje, por një goditje pozitive e rritjes prej 1 pikë përqindje zvogëlon papunësinë e të rinjve me vetëm 0.54 e një pikë përqindje", tregojnë analizat e Bankës Botërore.

Gjithashtu edhe mungesa e qasjes më të lehtë ndaj kredive zvogëlon mundësitë për punësimin më të lehtë të të rinjve. Të rinjtë në Evropën Juglindore në përgjithësi kanë qëndrime më pozitive ndaj sipërmarrjes se gjeneratat e vjetra, por vetëm një pjesë e vogël në fakt kanë filluar një biznes. Mungesa e financave dhe garancive të kredive të rinjtë, bie fjala, i kufizon mundësitë e tyre sipërmarrëse. Në mënyrë të ngjashme, mungesa e lidhjeve personale dhe profesionale i bën perspektivat e tyre të punësimit të dobëta.



Kërcënon axhën, ma jep vajzën për grua ose ju vras të gjithëve!

Shkup, 16 shkurt - Një rast i paprecedent është paraqitur të enjten në stacionin policor në Saraj. Dyzet e gjashtë vjeçari E.B. nga fshati Lubin i Shkupit, ka denoncuar se nga nipi i tij E.B. (19) i është rrezikuar siguria. Shkak për këtë sipas xhaxhait, është se nipi i tij përmes Viberit i ka dërguar porosi se do ta vrasë atë dhe familjen e tij nëse nuk ia jep vajzën, njoftoi policia. "Një ditë më parë, rreth orës 23 e 50 minuta i është paraqitur kushëriri i tij A.B. dhe e ka paralajmëruar të jetë i kujdesshëm sepse nipi i tij ka ikur nga shtëpia. Ai ka ikur pasi ka kuptuar se denoncuesi (xhaxhai 46 vjeçar) e ka fejuar vajzën dhe është revoltuar sepse ka qenë në lidhje dashurie me të. Denoncuesi po ashtu ka sqaruar se E.B. me datë 31.12.2017 e ka marrë vajzën e tij dhe dy ditë kanë qenë së bashku në një hotel në Tetovë pa lejen e tij dhe pasi nuk e ka ditur se ku gjendet vajza e ka paraqitur si të zhdukur në polici", njoftoi MPB.

Koha / Fisnik PASHOLLI

Shkup, 15 shkurt - Çdo i dyti i ri në Maqedoni dhe Greqi është i papunë, çdo i treti në Kosovë dhe çdo i katërti i ri në Kroaci.

Analizat tregojnë se në vitin 2016, Bosnja dhe Hercegovina ka qenë e para në rajon me 76.6 të të rinjve të papunë, ndërsa në vendin e dytë me gjysmën e të rinjve të papunë renditet Maqedonia.

"Të rinjtë në Maqedoni që nuk kanë punë ballafaqohen me periudha të gjata të kërkesës për punësim. Pjesëmarrja e të rinjve të papunë të moshës 15 deri 29 vjeç, që kërkojnë punë më shumë se një vjet është 34.2 për qind e numrit të përgjithshëm të të papunëve për një periudhë afatgjate në vitin 2016" thuhet në analizën e Entit të Statistikës.

Njohësit e kësaj problematike thonë se papunësia e të rinjve akoma paraqet problem të madh dhe sfida për shoqërinë tonë, që

MPPS SQARON RASTIN E MINORENES

13 vjeçarja nga "25 Maji", viktimë e eksploatimit seksual

Shkup, 16 shkurt - Në rastin për vajzën 13-vjeçare nën përkujdesje të institucionit publik për fëmijë me probleme sociale "25 Maji", për të cilën mediat publikuan se është abuzuar seksualisht dhe ka mbetur shtatzënë, me siguri bëhet fjalë për eksploatim seksual nga persona të jashtëm ose tregti me njerëz, dyshojnë nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Detyrë primare për momentin, theksojnë nga atje, është që vajza të vendoset në "Shelter qendror", një psikolog për fëmijë të punojë

me të, ndërsa MPB-ja ta hetojë lëndën dhe dyshimet se ajo është viktimë e tregtisë me njerëz. Nga Ministria theksojnë se e kanë shqyrtuar lëndën i cili është zhvilluar për vajzën nga ana e punonjësit social dhe institucioni, nga i cili kanë konfirmuar se disa herë më përpara e ka braktisur shtëpinë, e cila është e llojit të hapur, si dhe se çdoherë kur ka ikur, është denoncuar në polici. Sipas rregullativave ligjore, tutori - punonjësi social, nuk ka guxuar t'ia pengojë lëvizjen. Për herë të parë është gje-

tur në rrugë para QKR në Shkup në shtator të vitit 2017 dhe është kthyer në institucion, prej nga është vendosur në Shtëpi të sigurt ku vendosen viktimat të tregtisë dhe dhunës seksuale, por që edhe prej atje është larguar me kërkesë të saj.

"Çdoherë në deklaratat në polici ka dhënë deklaratat të ndryshme nga ajo se ka shkuar me të dashurin e saj, se ai me të cilin është larguar së bashku kanë përfutur, ose madje se pa pajtueshmëri ka pasur marrëdhënie seksuale me

persona të tjerë", thuhet në njoftimin e MPPS. Nga e gjithë kjo, thonë nga MPPS-ja, ndërsa duke pasur parasysh se bëhet fjalë për një vajzë minorene 13-vjeçare, mund të shihet se kjo ka qenë e manipuluar dhe keqpërdorur. Nga dokumentacioni, thonë nga Ministria, mund të shihet se punonjësi social dhe institucioni e kanë udhëhequr rastin në mënyrë korrekte. "Por, në qoftë se Komisioni që është formuar për këtë rast konfirmon ndonjë lëshim do të ketë masë disiplinore kundër pu-

nonjësit social dhe masës kundërvajtëse kundër eprorit të tij".

Vajza në vitin 2016, para se të vendoset në institucion ka qenë në pesë familje përkujdesëse, por në asnjërën prej tyre nuk është përshtatur.

Prindëret e saj u është marrë e drejta prindërore për shkak se e kanë detyruar të lypë nëpër rrugë. Ata kanë pasur edhe fëmijë, të cilët kanë vdekur si pasojë e konsumimit të drogës. Aborti është bërë me pajtueshmëri të vajzës dhe tutorit.

"Kosova po bën rrugë për vete, por edhe për vendet e tjera. Dëshirojmë të lidhemi Prishtinë-Shkup dhe besojë që kjo pjesë modeste nga Shkup në Bllacë në një gjatësi prej 13 kilometra që i mbetet palës maqedonase, të bëhet konkrete", ka thënë ambasadori Hysa

AMBASADORI I KOSOVËS NË EMISIONIN "ZIG ZAG" NË TV ART

SHKUPI TA KONKRETIZOJË AUTOSTRADËN DERI NË BLLACË



Shkup, 16 janar - Kosova me Maqedoninë ka shumë marrëveshje bilaterale në shumë fusha dhe tani kur në Maqedoni është një frymë tjetër, këto marrëveshje mundësojnë një rehati stabiliteti më të madh politik. Dhe, e gjithë kjo erdhi në shprehje pas vizitës që kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev i bëri Kosovës, ku edhe u konkretizuan disa ide siç është formimi i dy grupeve koordinuese për përgatitjen e një seancë të përbashkët midis Qeverisë së Kosovës dhe Maqedonisë, e cila do kontribuon në ngritjen në nivel më të lartë të raporteve që kanë këto dy shtete fqinje. Kështu ka thënë ambasadori i Kosovës në Shkup, Ylber Hysa, i cili në një intervistë për emisionin "Zig Zag" në Tv Art, ndërka shtuar se nga ana e Qeverisë së Maqedonisë ka gatishmëri për realizimin e një ideje të vjetër, gjegjësisht të punohet në pikat doganore të përbashkëta e që njehërësh është një lajm mirë për Pollogun.

"Kjo tregon se ka gatishmëri nga të dyja palët që kjo mos të bëhet vetëm për formalitet, por realisht te këtë një substancë dhe një lloj mekanizmi që do të implementojë të arriturat dhe në këtë aspekt - pse jo, edhe për çështjet infrastrukturore. Nga ana e Qeverisë së Maqedonisë ka gatishmëri për realizimin e një ideje të vjetër, gjegjësisht të punohet në pikat doganore të përbashkëta e që njehërësh është një lajm mirë për Pollogun", thotë Ylber Hysa, ambasadori i Kosovës në Maqedoni, duke përmendur këtu

pikën e përbashkët doganore Jazhincë-Glloboçicë.

"U dakordua që së shpejti të hapim qarkullimin e lirë në pikën doganore Jazhincë-Glloboçicë jo vetëm ekonomik, sepse është një korridor i natyrshëm dhe nuk ka logjik që eksportuesit bëjnë rrugën drejt kufirit të Bllacës", thotë Hysa. Ai njëherësh në këtë intervistë foli edhe për ndërtimin e autostradës Prishtinë-Hani i Elezit apo vendkalimin kufitar Bllacë, e cila lidhë Prishtinën me Shkupin. "Qeveria e Kosovës me mjete vetanake po

ndërton këtë autostradë. Sidomos punimet në grykën e Kaçanikut ku është një terren shumë i vështirë, po ndërtohet një urë impresive e gjatë 6 kilometra. Realisht, ndërtim i autostradës Prishtinë-Hani i Elezit nuk i ndihmon vetëm Kosovës, por seriozisht më shumë i ndihmon Maqedonisë. Mos të harrojmë se Kosova është partneri më i rëndësishëm i tregtisë i Maqedonisë, për shkak të shpenzimeve të ulta të transportit", thotë Hysa.

Me vetë faktin se Kosova është një vend i vogël në rajon, ambasadori ka thënë se po bënë shumë me mjete vetanake, sidomos në ndërtimin e rrugëve që janë shumë të rëndësishme për tu ndërlidhur me vendet e rajonit. "Kosova po bën rrugë për vete, por edhe për vendet e tjera. Dëshirojmë të lidhemi Prishtinë-Shkup dhe besojë që kjo pjesë modeste nga Shkup në Bllacë në një gjatësi prej 13 kilometra që i mbetet palës maqedonase, të bëhet konkrete. T'ju them një shifër zyrtare: gjatë vitit 2017 ka pasur 1.7 milion hyrje nga Kosova dhe 970 mijë hyrje nga Maqedonia në Kosovë. Flasim për një rrugë që frekuentohet për 2.7 milionë hyrje-dalje. Mos të përmendim kamionët, të cilët bartin mallra në një rrugë të shkurtër. Mos të harrojmë këtu se kosovarët kontribuojnë me 25 deri më 30 milionë euro në vit në turizmin mjekësor, pastaj kemi një numër të madh të kosovarëve që vikendeve vizitojnë Shkupin, Mavrovën dhe Ohrin. Gjitha këto janë shifra shumë reale që duhet parë si mundësi dhe ne presim që kjo të valorizohet në Maqedoni si një lloj oferte për hapje gjithnjë në kuadër të vlerave evropiane", thotë ambasadori Hysa.

QEVERIA ME BORXHE TË REJA

FONDET PENSIONALE, HUADHËNËSIT MË TË MËDHENJË

Brenda dy muajve për të kthyer borxhet e vjetra të marr në tregun vendor bankar, ka huazuar para në vlerë prej 136 milion për kthyer borxhin po atyre bankave në tregun vendor nga të cilta dhe qeveria i ka huazuara. Si kreditorë më të mëdhenj të Qeverisë janë Fondet Pensionale private me vlerë 558.5 milionë euro, bankat komerciale me vlerë me vlerë 543 milionë euro kompanive të sigurimi shteti u ka borxh 109.5 milionë euro në bazë të letrave me vlerë

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 16 shkurt - Ministria e Financave nga fillimi i këtij viti ka rritur presionin ndaj tregut vendor duke u futur në borxhe të reja tek bankat komerciale me qëllim për të kthyer borxhet e mbetura të huazuara vite më parë si dhe financimin e rrjedhës së buxhetit për këtë vit. Me marrjen e borxhit të fundit në vlerë prej 36 milion euro nga bankat vendore, nga ankandi i letrave me vlerë publikuar të martën më 13 shkurt, një ditë më pas me 14 shkurt, e gjithë kjo shumë do të shkojë për kthimin e borxheve të vjetra që shteti ua ka institucioneve financiare në tregun vendor. Përfundimisht me emetimin e fundi të letrave me vlerë në tregun financiar vendor, sipas Ministrisë së Financave janë realizuar disa ankande me vlerë të përgjithshme prej 136 milion euro dhe se borxhi i brendshëm, edhe përkundër huazimeve të reja gjatë dy muajve të parë të këtij viti, mbetet në nivelin e njëjtë - 1 miliardë e 505 milionë euro.

"Të gjitha huazimet që Qeveria

i ka bërë në tregun financiar vendor nga janari i këtij viti e deri në ankandin e fundit, realizuar ditën e martë, vlera e përgjithshme e borxhit të brendshëm mbetet po i njëjtë - 1 miliardë e 505 milionë euro, aq sa ishte deri në fund të vitit 2017. Kjo për shkak se të gjitha huazimet e mara deri më sot në tregun financiar vendor kanë shkuar për pagimin e borxheve të vjetra ndaj institucioneve financiare vendore të huazuara nga shtetit deri më fund të muajit dhjetor të vitit 2017.

Pra huazimet e reja aspak nuk kanë ndikuar në rritjen e borxhit, kështu që edhe 36 milion euro e huazuara në ankandin e fundit, e gjithë vlera e grumbulluar që sot do të shkojnë për shlyerje të borxheve të vjetra ndaj institucioneve financiare vendore", thonë nga Ministria e Financave.

Të dhënat e fundit të Ministrisë së Financave tregojnë se Fondet private të pensioneve, janë huadhënësit më të mëdhenj të qeverisë në tregun financiar vendas. Të dhënat

për vitin 2017 tregojnë se shoqëritë private të pensioneve marrin pjesë me shumën absolute më të lartë dhe përqindjen më të lartë në strukturën e letrave me vlerë të blera nga qeveria. Kështu, në bazë të gjitha letrave me vlerë dhe bonove të thesarit, të emetuara deri më sot, shteti fondeve pensionale private u ka borxh 558.5 milionë euro, bankave komerciale u ka borxh në vlerë të përgjithshme prej 543 milionë euro ndërsa kompanive të sigurimit borxhi i shtetit është 109.5 milionë.

BERZH ME STRATEGJI TË RE PËR MBËSHTETJE TË RËNDËSISHME TË MAQEDONISË

Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Zoran Zaev, së bashku me zëvendëskryeministrin e obliguar për çështje ekonomike dhe koordinim me resorët ekonomik Koço Angjushev, patën takim me delegacionin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), kumtoi shërbimi qeveritar për media. Delegacioni i BERZH-it i kryesuar nga Sharlot Ruhe, drejtoreshë për Evropën Qendrore dhe Juglindore, të cilën e shoqëruan edhe njerëzit e parë të zyrës së BERZH-it në RM, në fillim të takimit, uruan për vendimin e Komisionit Evropian që Maqedonisë t'i jepet rekomandim për fillim të negociatave për anëtarësim, në bazë të kushteve të

realizuara. Për BERZH-in u tha në takim, ky vendim i KE-së konfirmon se RM-ja po lëviz në rrugën e duhur, që për bankën është shenjë e mirë për ta vazhduar dhe në mënyrë shtesë ta intensifikojë bashkëpunimin me Qeverinë e RM-së. Në këtë fazë, bashkëpunimi fillimisht ka të bëjë me mbështetjen financiare të BERZH-it në lidhje me projektet aktuale në kuadër të Korridorit 8 siç është projekti për autostradën në pjesën Kriva Pallankë deri te kufiri me Republikën e Bullgarisë dhe linja kreditore për rikonstruim dhe rehabilitim të infrastrukturës rrugore në vend në gjatësi të përgjithshme prej 400 kilometrave.

Zhvendosja e kufirit të moshës së pensionimit nga 65 vite në 67 vite për burrat dhe nga 62 vite në 64 për gra, është i papranueshëm për bizneset private. Rritja e moshës së pensioneve do të ulët punësimi i të rinjve të shkolluar

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 16 shkurt - Zhvendosja e kufirit të moshës së pensionimit nga 65 vite në 67 vite për burrat dhe nga 62 vite në 64 për gra, propozim i dalur nga ekspertë ekonomik dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar si zgjidhje më mundshme për të zvogëluar vrimën në fondin shtetëror i cili nga viti në vit po rritet e që tani po shqyrtohet nga Qeveria e Maqedonisë, për sektorin e biznesit privat është i papranueshëm. Ky propozim sipas konfederatës së biznesit në Maqedoni është i papranueshëm dhe se ka mënyra tjera se si shteti të mbush Fondin pensional dhe invalidor të Maqedonisë e jo me sjelljen e masave të reja të cilat shkojnë në kurriz të punëtorëve. "Është një propozim i çuditshëm kur as qeveria e mëparshme por as kjo aktuale ende nuk kanë strategji apo plan konkrete se si të punojnë në përmirësimin e gjendjes financiare të Fondit aq më tragjike kur vetë fund nuk punon në këtë drejtim por vazhdimisht pret që shteti me para të buxhetit të mbyll gropën në fond të cilat për këtë vit që të mundet në kohë të paguan pensionet i nevojiten 550 milion euro", thotë Mile Boshkov kryetar i Konfederatës së biznesit në Maqedoni. Njehëri Boshkov thotë as njëri nga propozimet e ofruara nuk është i pranueshëm për

SEKTORI PRIVAT KONTESTON MOSHËN E PENSIONIT



RRITJA E PRAGUT, E PAPANUESHME

punëdhënësit. "E para edhe sikur të rritet për qindja e kontributeve nga 18 në 22 për qind sërish të dëmtuar do të jenë punëtorët sepse punëdhënësi kontributet për sigurim pensional invalidor i paguan në bazë të rrogës bruto kështu punëdhënësi do të zvogëlon rrogën neto të punëtorit për 4 për qind aq sa do të rrisë përqindjen e kontributeve të rrogës bruto", thotë Boshkov.

E dyta, dalja në pension pas moshës 67 vjet, thotë Boshkov, bizneset do të kenë probleme sepse nuk do të ketë produktivitet për shkak se një punëtorë mes viteve 60 -65 nuk është aspak produktiv në kryerjen e punës që e bën. "ë vend që të kemi fuqi punëtoreshë që vijnë me bastunë në punë më mirë është që këto punëtorë të shkojnë në pension para kohe dhe të zëvendësohen me të rinj. Biznesi privat ka nevojë për fuqi punëtoreshë ore të moshës së re nga 20 deri më 30 vite, sepse një punëtorë i moshës se mund të bënë punën e 10 punëtorëve të moshës 60 vjeçare. Pastaj me pranimin e punëtorëve të rinj jo vetëm që mund të rritet të hyrat e

kontributeve në Fond por dukshëm do të kontribuojnë në rritjen ekonomike për shkak se të rinjtë gjatë vikendeve dalin dhe argëtohen me shokë nëpër restorante apo kafene që do të thotë se me këtë rrisin fuqinë blerëse në krahasim më një punëtorë i moshës 60 vjeçare i cili mezi pret të shkon në shtëpi për të pushuar dhe kështu kursen çdo denarë të pagës mujore", thotë Boshkov. Ai vlerëson se do të ishte mirë që shteti të luftoj ekonominë joformale sepse një numër i madh i bizneseve pagat mujore të punëtorëve e japin në dy pjesë, gjysmën e rrogës përmes bankës me qëllim që të paguan më pak kontribute për sigurim pensional dhe gjysmën tjetër në dorë.

"Nëse punëdhënësit pagat mujore do ti paguan të plota përmes bankave atëherë me siguri se të hyrat nga kontributet në fondin pensional do të ishin më të larta", thotë Mile Boshkov, kryetar i Konfederatës së Bizneseve në Maqedoni.

Edhe nga Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri Perëndimore (OEMVP) shprehen të pakënaqur

ndaj propozimit për reforma në rritjen e kufirit të daljes në pension.

"Ndryshime të këtilla duhet të bëhen në pajtim me komunitetin e biznesit dhe sindikatat me qëllim që të zgjidhë problemin më të cilin po ballafaqohen vite me radhë biznesmenët e që ka të bëjë me mungesën e kuadrit të ri të fuqisë punëtoreshë" thonë nga OEMVP-ja. Rritja e moshës së daljes në pension për qytetarët sipas OEMVP-së nuk duhet të jetë opsion për reformimin e këtij institucioni. "Qeveria sheh vetëm aspektin financiar, kjo rritje e pragut të daljes në pension veçse e keqëson statusin e të moshuarve dhe në të njëjtën kohë frenon zgjerimin e punësimin për moshat e reja Nëse do të rritet mosha e pensioneve do të ulët punësimi i të rinjve të shkolluar dhe do të mbajmë më shumë në punë të moshuar kur dihet që kanë rendiment të ulët, dhe me këtë nuk rrisim produktivitetin në punë, gjë kjo që normalisht shkon në dëm të bizneseve", thonë nga OEMVP-ja.

Rriten kundërvajtjet në komunikacion

Tetovë, 16 shkurt - Stacioni policor i Tetovës për siguri në komunikacionin rrugor me aksionet e kontrollit të realizuara nga data 5 deri më 11 të këtij muaj, gjithsej janë përfshirë 181 automjete, nga të cilët 17 janë udhëzuar për të kryer kontroll teknik, pas çka dy prej tyre kanë pasur frenat e dëmtuar, përderisa 17 vetura të tjera kanë qenë të peregjistruar dhe për këtë arsye menjëherë janë përjashtuar nga komunikacioni. Në këto aktivitete kontrolli janë konstatuar edhe 26 kundërvajtje nga vozitës, të cilët kanë drejtuar automjete pa leje për vozitje, 10 kanë qenë vozitës fillestarë, 6 kanë biseduar në telefon celular gjatë drejtimit të automjetit, po aq automjetet ua kanë dhënë që t'i drejtojnë personave pa leje adekuate për vozitje dhe të ndryshme. Me kontrollet për ndalim dhe parkim të parregullt sërish janë përfshirë 200 automjete, prej të cilëve 181 kanë qenë gabimisht të parkuara ndërsa vozitësit do të përballen me 33 paralajmërime me shkrim si dhe 146 gjopa. Gjatë kontrolleve është vërtetuar se 34 vetura në mënyrë të palejuar kanë bërë tejkallim ndërsa 82 e kanë tejkalluar shpejtësinë e lejuar. Edhe këtë vit në rajonin më të gjerë të Tetovës vazhdon dukuria e vozitësve të cilët derisa drejtojnë makinat e tyre shfrytëzojnë telefona celularë që është në kundërshtim me ligjin për siguri në komunikacionin rrugor. Gjatë vitit 2017 janë sanksionuar 267 kundërvajtje të këtilla, ndërsa 185 vozitës kanë marrë dënime, kurse 82 janë paralajmëruar. Këtë vit ky lloj i kundërvajtjeve është 30. Ata, të cilët janë ndaluar duke drejtuar automjetin dhe njëkohësisht kanë folur në celularë do të përballen me dënim prej 40 euro dhe me 25 pikë negative. Poashtu në rritje e sipër është numri i vozitësve që nuk përdorin rrypin e sigurisë gjatë vozitjes. Gjatë vitit të kaluar në rajonin e Tetovës janë regjistruar 220 vozitës që nuk kanë shfrytëzuar rrypin e sigurisë ndërsa 171 janë paralajmëruar. Këtë vit shkelje të këtilla janë regjistruar 83 vozitës. (U.H)

NUK KA VEND PËR PANIK NGA KRIZË E RE FINANCIARE

Shkup, 16 shkurt - Banka Qendrore Evropiane nuk do t'i rrisë normat e interesit, siguron Beno Kere, anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Bankës Qendrore Evropiane. Në konferencën e djeshme për shtyp në Shkup, Kere tha se nuk ka vend për panik nga kriza e re financiare pas rënies së bursave periudhën e kaluar. Ai theksoi se Banka Qendrore Evropiane e përcakton normat e interesit përkatësisht me kushtet në rajon veçanërisht në zonën evropiane. "Ato janë të ndryshme nga ato në SHBA dhe dëshirojmë të sigurohemi se kemi kushte financiare përkatëse në zonën evropiane të cilat janë përkatëse në gjendjen ekonomike. Kemi politika të qarta



lidhur me ciklin afarist që përdorohet në eurozonë, për dallim nga Amerika dhe nuk do t'i rrisim normat e interesit para ciklit të ardhshëm, që do të thotë se ato do të mbesin në nivel të njëjtë", theksoi

Kere duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve.

Lidhur me tronditjet e fundit të bursave, Kere tha se në përgjithësi dy javëve të fundit kanë treguar se ekonomia globale edhe më tej

është në rrezik, dhe se ekzistojnë rreziqe të cilat vijnë nga vende të ndryshme përfshirë edhe tregjet në zhvillim. "Ne jemi të fokusuar në eurozonë dhe në vendet fqinje përfshirë edhe Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Thjesht duhet të krijojmë mjedis të këndshëm financiar ku mundet fuqimisht të qëndrojmë në këmbë dhe t'i përballojmë goditjet e tilla. Kjo bëhet me një ekonomi të fuqishme lidhur me letrat me vlerë", tha Kere. Sipas tij, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë mirë e ka vendosur politikën monetare në vend me çfarë në mënyrë përkatëse u është përgjigjur goditjeve nga kriza financiare që kaloi.

I JEPET LAMTUMIRA E FUNDIT ABDILAQIM ADEMIT



Në orët e pasdites, në Komunën e Tetovës është mbajtur edhe mbledhje komemorativë kushtuar Abdilaqim Ademit

Tetovë, 16 shkurt - Në moshën 49 vjeçare ka ndërruar jetë të enjten mbrëma Abdilaqim Ademi, funksionarë i lart i Bashkimit Demokratik për Integrim. Ai, të premten në mesditë është varrosur me nderime fetare në varrezat në fshatin Shemshovë në vendlindjen e tij. Në ceremoninë e varrimit, fjalim para të pjesëmarrësve ka mbajtur Bujar Osmani në emër të Bashkimit Demokratik për Integrim. Ai tha se Abdilaqim Ademi nëpër vite kontribuoi si në sferën politike, po ashtu edhe në atë kombëtare. "Në cilësinë e Sekretarit të përgjithshëm dhe Shefit të Shtabit zgjedhor të BDI-së, Qjma ishte motori që na çoi nga fitorja në fitore. Si bartës i funksioneve të larta shtetërore dhe kombëtare, si deputet, si zëvendëskryeministër për Implementimin e Marrëveshjes së Ohrit, si ministër i Ambientit Jetësor dhe së fundi si ministër i Arsimit,

Abdilaqim Ademi bëri që edhe gjithë shqiptarët të ndjejnë për të mirën dorën e shtetit. Një varg projektesh dhe shkollash mbajnë e jo më larg se themelimi i një universiteti shtetëror në gjuhën shqipe Nëna Terezë, janë projekte që mbajnë firmën e njeriut të butë e të urtë të Abdilaqim Ademi", tha Osmani. Ai u shpreh se projektet që kanë ngelur përgjysmë do të mundohen që ti çojnë deri në fund. Në emër të Bashkësisë Fetare Islame, nga Muftinia e Tetovës fjalim mbajti Ejup Efendi Selmani. "Abdilaqim Ademin si BFI e kujtojmë si kontribuues edhe në realizimin e të drejtave tona fetare", tha Selmani. Në emër të Bashkësisë Lokale të fshatit Shemshovë, fjalim mbajti edhe nxënësja Iliriana Ejupi e cila tha se Abdilaqim Ademi do të mbahet mend për veprat e tij.

"Shkolla fillore në fshatin

Shemshovë ndjehet krenare që në bankat e kësaj shkolle morri njohuritë e para Abdilaqim Ademi. Veprimtarinë e tij nuk mundet ta përshkruajmë, por flasin vetë veprat e tij si politikan dhe personalitet i ndërgjegjshëm", tha ajo. Në funeralin e tij kanë marrë pjesë pjesëtarë të lartë të organeve partiake të BDI-së, në krye me kryetarin Ali Ahmeti. Me rastin e vdekjes së tij, telegrame ngushëllime kanë dërguar krerët dhe funksionarë të tjerë shtetërorë - në mesin e tyre edhe kryeministri Zoran Zaev. Në orët e pasdites në Komunën e Tetovës është mbajtur edhe mbledhje komemorativë kushtuar Abdilaqim Ademit. Abdilaqim Ademi lindi më 20 dhjetor 1969 në fshatin Shemshovë të Tetovës. Studimet universitare i kishte filluar në Fakultetin e Xehetarisë dhe Metalurgjisë, drejtimi Metalurgji, në qytetin e minatorëve në Mitrovicë,

ku kishte mbaruar dy vite dhe për shkak të masave të dhunshme serbe në Universitetin e Prishtinës, studimet ishte detyruar që t'i vazhdoj në Universitetin Politeknik të Tiranës, ku ka diplomuar në korrik të vitit 1996. Më pas ka mbaruar edhe studimet postdiplomike. Ai ishte zëvendëskryeministër për zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit në Qeverinë e Maqedonisë që nga viti 2008, ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor 28 korrik 2011 deri më 20 qershor 2014 dhe ministër i Arsimit dhe Shkencës në periudhën prej 20 qershorit 2014 deri më 16 janar 2016. Ndryshe, Abdilaqim Ademi la pas vetes bashkëshorten dhe djalin. Ai së fundmi vuante një sëmundje e pashërueshme, ndërsa prej kohësh kur nuk ishte ministër i Arsimit dhe Shkencës, ai shumë rrallë është paraqitur në opinion duke luftuar më sëmundjen e tij. (U.H)

Përkujtohen ligjëratat e para në UT

Tetovë, 16 shkurt - Në Universitetin e Tetovës është mbajtur Akademi solemne kushtuar 23 vjetorit të fillimit të ligjëratave të para në Universitetin e Tetovës. Për rëndësinë e kësaj date, para të pranishmëve dhe pjesëmarrësve në Akademi edhe nga Universiteti i Tiranës foli rektori Vullnet Ameti. Ai nënvizoi rëndësinë historike të hapjes së Universitetit të Tetovës për edukimin e gjeneratave të reja. "Përgjatë 23 viteve, Universiteti ynë e realizoi misionin e vet arsimor, i realizoi objektivat e veta dhe u shndërrua në Universitet publik në kuadër të sistemit arsimor të Maqedonisë. Ne u shprehim mirënjohje dhe falënderime të përzemërta të gjithë atyre që kontribuan për themelimin dhe të arriturat e derisotme të këtij Universiteti. Falë mbështetjes së tyre, djersës së arsimdashësve, punës së pareshtur të qindra pedagogëve, Universiteti ynë dhe i Juaji tanimë është ngritur në një institucion të arsimit të lartë që promovon vlera arsimore dhe shkencore, të pranueshme edhe në hapësirën evropiane", theksoi rektori i UT-së Vullnet Ameti. Ai falënderoi edhe studentët e parë dhe të gjithë ata që kontribuan për këtë universitet. "Në mënyrë të veçantë, i falënderojmë nga zemra dhe u shprehim mirënjohje të përzemërta familjeve shqiptare që shtëpitë e tyre i shndërruan në mesonjëtorë të para të këtij Universiteti. Studentët e gjeneratës së parë, profesorët dhe bashkëpunëtorët që dhanë kontribut për ngritjen, përparimin dhe konsolidimin e këtij institucioni të vetëm të arsimit sipëror në gjuhën shqipe dhe për mbarëvajtjen e procesit edukativ-arsimor të tij, sidomos profesorët nga Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Tiranës dhe më gjerë", tha rektori Ameti. Po ashtu, në këtë Akademi ka marrë pjesë nga Shqipëria, Ismail Keta, kampion bote i Kik Boksit. Përndryshe, gjatë ditës janë bërë homazhe tek varri i rektorit të parë të këtij universiteti, tashmë të ndjerit Fadil Sulejmani, vizitë në muzeun në fshatin Porroj, homazhe tek busti i dëshmorit Abdilselam Emilit dhe njëkohësisht rektori vizitoi edhe familjen Emili. (U.H)

Dogani i sëmurë rëndë, Shutka pret lejen e Gjykatës Penale

Shkup, 16 shkurt - Gjendja shëndetësore e Rufki Doganit, të akuzuarit të grupit të Kumanovës, i cili në nëntor të vitit të kaluar u dënua me 40 vite burg, për disa ditë me radhë nuk është e mirë më shëndet. Me vendimin e Gjykatës Penale të Shkupit, Dogani nga dita e arrestimit më 9 maj të vitit 2015 e deri më sot vazhdon të qëndrojë në burgun hetues të Shutkës. Edhe pse shpeshherë është ankuar për gjendjen e rëndë shëndetësore, qoftë gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor për "Lagjen e Trimave", por edhe pas shqiptimit të dënimit, megjithatë përmirësimi i gjendjes së tij fizike dhe psikike nuk ka



ndodhur. Drejtori i ri i burgut të Shutkës, Gjoko Kotevski, i cili në këtë pozitë figuron nga fillimi i këtij viti, në një prononcim për gazetën KOHA, tha se është i njoftuar me rastin e Doganit dhe me

gjendjen e tij shëndetësore. "Gjithsesi ne e përcjellim gjendjen shëndetësore të të burgosurve, por edhe të vetë Rufki Doganit. Me qëllim realizimin e analizave të detajuara, kemi kërkuar nga Gjykata Penale e

Shkupit leje për dërgim të Doganit në Qendrën Klinike të Shkupit. Shpresoj se së shpejti do ta marrim lejen nga kjo gjykatë dhe të burgosurin në fjalë të dërgojmë në spital", tha drejtori Kotevski. Mes tjerash, ai nënvizon se Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve është drejtë përfundimit të dokumentacionit, i cili parasheh që Shtëpia e Shëndetit Shkup ta merr përsipër kujdesin mjekësor të të burgosurve në këtë burg hetues. Ndryshe, muaj më parë, Rufki Dogani, duke dashur të alarmojë për gjendjen e tij, në qelin e tij, ka shkaktuar një zjarr i cili është shpërndarë me ndezjen e dyshekut ku ka fjetur. (O.XH)

Maqedonia dhe shqiptarët

Nga
Arben TARAVARI



Këto kohë është shtuar shumë zhumra e çështjes së emrit të Maqedonisë. Ballkani si një nga gadishujt më të çuditshëm të kontinentit të Vjetër edhe pse në shekullin e 21, ka kështu debatesh që shumë shpejt kalojnë në sherre si ky i emrit të një shteti! Për një fatum të ligë sherret ballkanike ju ngjasojnë shumë shpesh sherreve të plakave 100 vjeçare, por që rrezikojnë fatin e brezave të rinj e deri të atyre të palindur.

Duket sikur marrëdhëniet e tendosura greko-maqedonase papritur kaluan në një gati romancë ballkanike por që fatkeqësisht rezultoi të jetë një Flirt jetëshkurtër të paktën nga Greqia e cila pati qindra dhe mijëra qytetar dhe jo vetëm të rreshtuar në rrugë duke bërë titur fort se Maqedonia është vetëm emër i tyre! Sherri nuk bëhet për tokë por për emër. Nuk është sherr floriri, nikeli, bakri apo çeliku por është sherr shkronjash, kodesh, historie! Të armatosur deri në fyt me argumente sa objektivë e sa subjektivë dy shtetet u dukën se ishin në prag të një marrëveshje, por krushqit grekë duket se e nuk janë dakord me kushtet e dasmës... a ne na intereson doemos një Greqi e kënaqur me sa duket për hir jo vetëm të shkronjave e historisë po edhe për hir të qetësisë të vështirë të tokës tonë.

Gjithsesi, këto ulje-ngritje janë gati normale për gadishullin e çuditshëm. Ajo ç'ka nuk është aspak e natyrshme është mospërfshirja e shqiptarëve në këtë çështje!

Çfarë i bën maqedonasit që tashmë rrezikojnë edhe të drejtën për t'u quajtur të tillë, të mos konsiderojnë shqiptarët si popull që ka të drejtë legjitime, morale dhe qyteta-

re për të qenë pjesë e diskutimeve për emrin?! Çfarë janë shqiptarët për Maqedoninë?

Shqiptarët janë banorë autoktonë të këtyre trojeve. Shqiptarët janë popull që i njeht kushtetuta e këtij shteti. Shqiptarët janë furnizues aktiv dhe shumë të rëndësishëm të Thesarit të shtetit.

Paratë që grumbullohen nga taksatpaguesit shqiptarë e sidomos ato që vijnë nga Mërgata Shqiptare, shfrytëzohen për të investuar në mirëqenien e maqedonasve, shqiptarëve, turqve, bullgarëve, romëve që jetojnë në këtë shtet me emrin e papërshtatshëm për grekët. Shkojnë e vijnë në Greqi e botë duke shfrytëzuar paratë tona por nuk na pyesin asgjë për çfarë do thonë. Kryeministri aktual mori vota të shqiptarëve si asnjë kryeministër tjetër, tash pse nuk merr mendimin e tyre për një çështje kaq delikate si kjo e emrit?! Thonë se tradhtia është më e madhe nga ai që i ke besuar më shumë. Ne nuk jemi fqinjë për maqedonasit, jemi bashkëqytetarë, jetojmë në të njëjtën bashkësi ligjore dhe administrative, paguajmë të njëjtat taksa dhe madje nuk marrim të njëjtat përfitime. Tash të kthehemi tek Çështja e Emrit.

Nuk po i ndryshohet emri djalit të Kostës apo të Jovankës, por po i ndryshohet emri një shteti, një shteti që është i Kostës, i Jovankës, por edhe i Arbit dhe Albanës! Nëse vizioni i Qeverisë aktuale është që të ketë një shtet, atëherë duhet që të kuptojë se ai shtet përbëhet nga të gjithë etnitë e tij. Shqiptarët nuk mund të prishin punë për maqedonasit, me hir a me pahir kemi treguar gjithnjë që kemi rregulluar punët për këtë shtet! Presidenti Xhon F. Kenedi

do të thoshte një shprehje nga më të dashurat e më të drejtat në kontekstin e shtetit: Mos pyet çfarë bën shteti yt për ty, por çfarë bën ti për shtetin tënd!

Na lini të bëjmë dhe ne, na lejoni të ndjehmë që kemi shtet e që jemi pjesë e vendimmarrjeve të tij. Çështja e emrit duket sikur është një rast i klasifikuar për shqiptarët. Nuk mund të pretendohet për të qenë pjesë e Evropës Institucionale ku ende kemi të pazgjidhur brenda vetes marrëdhëniet etnike, barazinë e tyre!

Gjithë kohës, për fat të keq edhe tani, shqiptarët duket se janë një lloj qenie inferiore përballë politikës qendrore. Nuk e di nëse kjo është një përshtypje e krijuar prej funksionit Yes Sir (Po Zotëri) të partisë shqiptare në pushtet ndaj pushtetit maqedonas, nuk e di nëse kjo është krijuar për shkak të ndonjë keqkuptimi historik por di që ajo çfarë ka rëndësi titanike tani është përfshirja e faktorit shqiptar në zgjidhjen e emrit të shtetit!

Përfshirja e shqiptarëve ka rëndësi më shumë se vet emri. Këtë nuk e them për shkak të ndonjë kompleksit nacionalo-shovinist pavarësisht se kemi qenë jo rrallë herë viktimë të këtij kompleksi, por e them me vizionin e një njeriu që kërkon të ardhme të paqte e më të mirë për fëmijët e tij. Sido që të vendoset për emrin duhet të jemi pjesë e vendimit dhe kjo është aksiomatike për një shtet demokratik, ndryshe shkojmë në diktaturë totalitare, shkojmë aty ku regjimet nuk rrezikojnë vetëm emrin e shtetit por vet ekzistencën e tij. Si pjesë e zgjidhjes së këtij ngërçi më tepër etnik se sa politik, do ishte shumë e dobishme që për këtë çështje të organizohej një Këshill apo Senat i përbërë nga eminentat e mendimit dhe intelektit në Maqedoni. Ky organ duhet të ketë përfaqësues të çdo etnie bazuar në statistikën e përqindjes së kombeve dhe këta përfaqësues duhet të jenë kryesisht njerëz të shkencës, historisë dhe kulturës të cilët kanë pasaporta më të besueshme për të analizuar emra më pëlqyeshëm për të dyja palët. Propozimet kryesore të këtij organi mund të hidhen më pas të diskutohet a ka nevojë apo jo për një referendum dhe populli gjithnjë inteligjent do ketë fjalën e fundit dhe kryesore për këtë Çështje. Nëse shqiptarët nuk bëhen pjesë e zgjidhjes automatikisht nënkuptohen si pjesë e problemit.

E dini si? Ne kemi një shtëpi që dita ditës ka nevojë për para që të ketë çati më të fortë, dyer më të mira, dritare më të mëdha, e një nga ata që punon për këtë shtëpi janë Shqiptarët. Mirëpo tani që duan që shtëpisë t'i zgjedhin një ngjyrë tjetër për çatinë sepse nuk i pëlqen lagjes le të themi, shqiptarët nuk pyeten fare...ne nuk jemi vetëm bojxhinjtë, jemi dhe ata që blejmë bojën e si një nga pronarët legjitimë kemi të drejtë të vendosim për ngjyrën e saj.

Ndaj si përfundim le t'i japim Çezarit çfarë është e Çezarit, le t'i japim shqiptarëve për herë të parë barazinë që u takon me të drejtën e Ligjit dhe me të drejtën e Hyut në këtë shtet që ndoshta dhe për pak kohë do të quhet Maqedoni, por shqiptarët do i duhen shumë më gjatë, sepse pa ta shteti nuk do kishte kuptim pavarësisht çfarë emri që do kishte.

(Autori është kryetar i Komunes së Gostivarit, njëherësh Sekretar i Aleancës për Shqiptarët)

Nuk po i ndryshohet emri djalit të Kostës apo të Jovankës, por po i ndryshohet emri një shteti, një shteti që është i Kostës, i Jovankës, por edhe i Arbit dhe Albanës! Nëse vizioni i Qeverisë aktuale është që të ketë një shtet, atëherë duhet që të kuptojë se ai shtet përbëhet nga të gjithë etnitë e tij. Shqiptarët nuk mund të prishin punë për maqedonasit, me hir a me pahir kemi treguar gjithnjë që kemi rregulluar punët për këtë shtet!



KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi


Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e premtë 16 shkurt | Numri i parë i gazetës do të 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3179 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

FJALËKRYQI KLASIK

HORIZONTALISHT

3. Aktori amerikan, Çarli
5. Jevg
7. Pjesët e drurit
9. Mashkulli i rosës
10. I biri i Reas
12. Kundërligjor
13. Njësi ushtarake, batalion
15. Endacak
16. Element kimik (Te)
18. Kali i shalës
20. Amënor
23. Industria kroate e naftës
24. Gurrat
26. Kafshë gjitare e egër
28. Qëndisje me lule, ojarë
29. Skotlandeze, skoceze
30. Aktorja kroate, Begoviq
31. Kalium
33. Këngëtare shqiptare që jeton në Zvicër, "O sheqer"
43. Jon me ngarkesë pozitive
42. Sheshi i Venedikut
43. Prodhim qumështi
44. Ish politikani turk, Ismet
48. Kafshë shtëpiake (sh.)
49. Paraardhësi ynë.



VERTIKALISHT

1. Vezë e fekonduar
2. Agjencia e zbulimit Izraelit
3. Këngëtarja amer. (Cherilyn Sarkisian)
4. Mallkimi
5. Ish trio kosovar
6. Pyll
8. Gyp gazrash
9. Bakër
11. Lëngu i syrit
12. Limani
14. Reniumi
15. Shifra
17. Aktorja dhe këngëtarja në foto
18. Banor i hershëm i një vendi
19. Makinë luftarake e blinduar
21. Zoti egjiptas, Ra
22. Nusja
23. Internet Protocol
25. Tantali
27. Tërësia e emrave të vendeve
30. Brend i njohur mode (Hong Kong)
32. Astat
33. E bëj të vakët
34. Pjesë e molekulës
35. Dru pylli i lartë
36. Aktorja amerikane, Derek
37. Përemër vektor
38. Krahinë në Shqipëri
39. Bar
40. Vegël muzikore me katër palë tela
45. Lart (geg.)

Kakuro

e lehtë

			3	30	
		7			
17	30				
25					3
17			8		
		3			
	18				
	11				

mesatare

		16	17	35	
	16				
	3				
17					4
6			11		
		4			
	13				
	16				


e vështirë

		25	17		
	10				
	13			15	
29					4
14			9		
		14			
	20				
		6			




LABIRINTI

Cilën rrugë duhet ta zgjedhë qeni që të arrijë deri te ushqimi?




VIZATIMI

Vizatoni duke i bashkuar pikat me radhë!




FSHEHËSIRA

Gjej figurat që fshihen në fotografi!



DALLIMET

Gjej 6 dallimet në fotografitë e mëposhtme!





BE QORTON FACEBOOK DHE TWITTER

Në një kohë kur Google i ka përshtatur rregullat e platformës së saj Google plus në një masë të konsiderueshme me kërkesat e Komisionit, Facebook dhe veçanërisht Twitter nuk kanë vepruar kështu. Pika shumë të rëndësishme ata i kanë marrë parasysht vetëm pjesërisht, bëri të ditur Komisioni Evropian. Veçanërisht janë procedurat për bllokimin e përmbajtjeve dhe të llogarive të përdoruesve ku ndeshen problemet më të mëdha. Komisarja për Drejtësinë e BE, Vera Jourova deklaroi se propozimet e paraqitura deri tani nga këto sipërmarrje janë të pamjaftueshme. "Mbrotjtja e konsumatorëve në BE duhet respektuar," tha

BE i ka kritikuar ashpër rrjetet sociale Facebook dhe twitter: sipas Komisionit të BE ato nuk i respektojnë sa duhet ligjet për mbrojtjen e të dhënave të konsumatorëve në Evropë

Jourova. "Nëse sipërmarrjet nuk i përmbahen kësaj, ato duhet të mbulohen me gjoba". Këtyre sipërmarrjeve u qe kërkuar që në nëntor 2016 që ta përshtasin mbrojtjen e


tyre për konsumatorët me rregullat e BE. Sipas vlerësimit të Komisionit, Twitteri vazhdon t'i ndryshojë kushtet e përgjithshme tregtare pa i informuar për to përdoruesit. Përdoruesit e Twitterit dhe të Facebookut veç kësaj nuk informohen në kohën e duhur dhe jo mjaftueshëm për fshirjet që i kërcënojnë të përmbajtjeve të dyshuara si ilegale, kritikoi Komisioni. Edhe për mundësinë që të paraqitet ankesë kundër fshirjeve që priten ose që kanë ndodhur nuk jepet informacioni i mjaftueshëm. Një zëdhënese e Facebookut deklaroi në lidhje me kritikën se këtë vit janë parashikuar ndryshime. Këtu bën pjesë p.sh. mundësia për

t'i informuar përdoruesit më mirë për fshirjen e përmbajtjeve. Jourova tha më tej se rrjetet sociale i përdorin si platforma publicitare dhe tregtare dhe ato duhet t'u përmbahen nga ky shkak rregullave të mbrojtjes së konsumatorëve.

Kërkesa qendrore të Komisionit të BE ishin p.sh. një e drejtë tërheqjeje në blerjet në internet dhe kompetenca e gjykatave evropiane, që të ngrenë padi mbi bazën e së drejtës nacionale. Më parë, Google, Facebook dhe Twitter parashikonin që në rast konflikti, ai të zgjidhej mbi bazën e ligjeve të Kalifornisë, sepse atje e kanë qendrën këto firma.

Zarf me "pluhur të bardhë" në disa ambasada

Në disa ambasada të huaja në kryeqytetin e Rusisë, Moskë, janë dërguar zarfe brenda të cilave ka patur pluhur të bardhë. Në një deklaratë nga Drejtoria Policore e Moskës për agjencinë ruse të lajmeve RIA Novosti thuhet se në disa ambasada në Moskë janë dërguar zarfe brenda të cilave kishte pluhur të bardhë. Zyrtarët policorë kanë konfiskuar zarfet në fjalë dhe kanë filluar hetime lidhur me këtë rast. Sipas vlerësimeve të para njoftohet se nuk është gjetur substancë e dëmshme brenda zarfeve. Nuk janë dhënë informacione lidhur me atë se në cilat ambasada janë dërguar këto zarfe ndërsa disa burime të cilat nuk dëshirojnë të zbulojnë emrat, pretendojnë se njëri nga zarfet është dërguar në Ambasadën e Holandës. Ndërsa në Ambasadën e Turqisë në Moskë nuk është dërguar një zarf i tillë. Gjatë ditëve të fundit në vende të shumta janë dërguar zarfe me pluhur të bardhë, përfshirë edhe bashkëshorten e djalit më të madh të presidentit të SHBA-ve Donald Trump, Donald Trump Jr.



Tillerson: Turqia ka të drejtë legjitime për mbrojtjen e kufijve

Sekretari amerikan i Shtetit, Rex Tillerson ka thënë se Shtetet e Bashkuara e njohin të drejtën legjitime të Turqisë për të mbrojtur kufijtë e saj. Ai i ka bërë këto deklaratë gjatë një takimi në Ankara me qëllim të uljes së tensioneve në mes të dy aleatëve të NATO-s. Pasi ka biseduar me ministrin e Jashtëm turk, Mevlut Cavusoglu, Tillerson i ka bërë thirrje Ankarasë të tregojë përmbajtje gjatë operacioneve në rajonin Afrin të Sirisë dhe të mënjanojë hapa që mund të përshkallëzojnë tensionet. Duke folur



në konferencën e njëjtë për media, Cavusoglu, ka thënë se Turqia dhe Shtetet e Bashkuara janë pajtuar për nevojën e normalizimit të

marrëdhënieve bilaterale, duke premtuar krijimin e "mekanizave" për të diskutuar çështjet problematike.

Turqia është e zemëruar për mbështetjen e Uashingtonit ndaj milicëve kurdë, të njohur si Njësitë për Mbrojtjen e Popullit (YPG). Turqia e konsideron YPG-në si grup terrorist, të lidhur me rebelët kurdë që luftojnë brenda Sirisë. Mirëpo YPG ka qenë aleatja kryesore e SHBA-së, në luftimin e grupit ekstremist, Shteti Islamik në Siri. Tillerson është takuar më 15 shkurt me presidentin turk, Recep Tayyip Erdogan për më shumë se tri orë. Në fund të dy palët kanë thënë se diskutimi ka qenë produktiv mirëpo jo vendimtar.

Ndalesa e udhëtimit diskriminon muslimanët

"Duke shqyrtuar deklaratat zyrtare nga presidenti Trump dhe zyrtarë të tjerë së bashku me vetë shpalljen, konkludojmë se shpallja është jokushtetuese e njollosur me armiqësi ndaj Islamit"

Përpjekja e fundit e presidentit amerikan, Donald Trump, për të kufizuar imigracionin është ballafaquar me një tjetër pengesë gjy-

qësore nga një gjykatë federale e apelit në Virginia. Në një vendim 9 me 4, gjykata vendosi se dekreti i udhëtimit nga Trump është jokushtetues, sepse ai diskriminon muslimanët. Vendimi i shumicës citoi postimet në Twitter të presidentit Trump dhe deklaratat e tjera publike të tij si dëshmi se qëllimi i dekluar pas rendit ekzekutiv, sigurisë kombëtare, është dukshëm "veshje e dritares" për qëllimin e saj të vërtetë. "Duke shqyrtuar deklaratat zyrtare nga presidenti Trump dhe zyrtarë të tjerë të degës ekzekutive, së bashku me vetë shpal-

ljen, konkludojmë se shpallja është jokushtetuese e njollosur me armiqësi ndaj Islamit", shkroi kryeprokurori Roger Gregory. Gregory poashtu theksoi se ata që e apelojnë rendin ekzekutiv "ofrojnë dëshmi të padiskutuueshme se presidenti i SHBA-ve në mënyrë të hapur dhe shpesh shpreh dëshirën e tij për t'i ndaluar ata të besimit islam që të hyjnë në SHBA".

Varianti i fundit i ndalesës së udhëtimit i bllokoi njerëzit nga tetë vende që të hyjnë në SHBA, gjashtë prej të cilave janë shumicë muslimane. Dekreti ndalon imigri-

min nga Çadi, Irani, Libia, Somalia, Siria dhe Jemeni, si dhe nga Koreja e Veriut dhe Venezuela. Gjykata Supreme në muajin prill pritet të dëgjojë argumentet në këtë rast. Cecilia Wang, zëvendës drejtorja ligjore e Unionit Amerikan të Lirive Civile, përshëndeti vendimin e Gjykatës së Apelit të Qarkut të katërt. "Përrpjekja e tretë e paligjshme e presidentit Trump për të denigruar dhe për të diskriminuar muslimanët nëpërmjet një ndalesë të emigracionit ka dështuar përsëri në gjykatë. Nuk është çudi. Kushtetuta ndalon veprimet e qeverisë

kundër një feje", tha Wang. Si kandidatat që konkurron për zyrën më të lartë të Amerikës, Trump u zotua të miratojë "një mbyllje totale dhe të plotë të muslimanëve që hyjnë në SHBA derisa përfaqësuesit e vendit tonë të kuptojnë se çfarë po ndodh". Ndërkohë, në detyrë si presidenti amerikan, ai ka hedhur tre përpjekje të ndara për të përmbushur premtimin, por përpjekjet janë ballafaquar me pengesa ligjore të njëpasnjëshme. Gjykata Supreme lejoi që varianti i tretë të hyjë në fuqi derisa procedimet ligjore vazhdonin.

10-vjetori i pavarësisë e gjen Kosovën me një perspektivë të zymtë. Qytetarët e Kosovës vazhdojnë të mbeten pa lëvizje të lirë në zonën Shengen e BE-ja nuk duket e qartë në strategjinë për integrimin e Kosovës

Dhjetë vjet pas shpalljes së pavarësisë, projekt ky që u mbështet nga shumica e vendeve demokratike, Kosovën e kanë njohur 114 shtete të botës. Gjatë kësaj periudhe dhjetë vjeçare, Kosova përmbylli mbikëqyrjen ndërkombëtare të pavarësisë, nisi dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, i cili akoma nuk ka përfunduar, themeloi Gjykatën Speciale për Krime Luftë dhe po vazhdon përpjekjet për t'u përfshirë në strukturat evropiane, ndonëse qytetarët e saj akoma nuk mund të lëvizin lirshëm në zonën Shengen. Kosova akoma nuk cilësohet shtet i pavarur nga Bashkimi Evropian, ndonëse 23 shtete të BE-së individualisht e njohin pavarësinë e saj. Në strategjinë e fundit të BE-së për Ballkanin, tek pjesa për Kosovën, u tha se "Kosova ka mundësi të bëjë përparim të qëndrueshëm me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) dhe të avancojë në rrugën e saj evropiane, kur të lejojnë rrethanat objektive".

10 VITE PAVARËSI - PËRPARIM POR EDHE NGEÇJE

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, për dhjetëvjetorin e pavarësisë së Kosovës, thotë se "dhjetë vitet e fundit kanë qenë vite të përparimit të gjithanshëm të Kosovës, duke u njohur nga 115 vende të botës, kultivim të raporteve të mira me aleatët ndërkombëtarë si dhe vite të relaksimit të raporteve me Serbinë". Por, shqetësim për Presidentin mbetet "izolimi i qytetarëve të Kosovës nga BE-ja, moslëvizja e tyre e lirë në zonën shengen". Njohësi i zhvillimeve rajonale Naim Rashiti, nga Brupi Ballkanik për Politika, i tha DW-së se pas sh-

10 VJET SHTET



palljes së pavarësisë Kosova u ballafaqua me tema të mëdha që prekën edhe sovranitetin e saj dhe kjo bëri që pritjet e qytetarëve të ngecin.

"Realiteti është që shoqëria kosovare nuk ka pasur përvojë në ndërtimin e institucioneve dhe nuk ka pasur një projektion se si do të ecin vitet e pavarësisë, si do të duket 10 vjeçari, 20 vjeçari i pavarësisë e kështu me radhë dhe premtimet që janë dhënë në atë kohë me shumë kanë qenë shprehëse sesa një realitet. Kosova pas shpalljes së pavarësisë është ballafaquar me çështje të mëdha sa i përket sovranitetit të brendshëm dhe të jashtëm dhe kjo e ka vonuar konsolidimin e plotë të pavarësisë dhe ka penguar që të materializohen pritjet që kanë qenë", thotë Naim Rashiti.

Zoti Rashiti mendon se megjithë ngeçjet në Kosovë pas shpalljes së pavarësisë, janë shënuar edhe arritje që vlerësohen nga spektri politik. "Megjithatë, arritje ka, sepse është përmbjllur mbikëqyrja e pavarësisë së Kosovës, ka 115 njohje dhe shteti deri diku është konsoliduar. Për njerëzit që janë afër proceseve politike këto janë arritje të konsiderueshme, ndërsa, për shoqërinë dhe gjeneratat e reja këto arritje janë shumë të mangëta. Prandaj ky 10 vjetor e gjen shoqërinë kosovare në një lloj

depressioni, sepse shteti nuk arritur të plotësojë kërkesat minimale të qytetarëve sa i përket shërbimeve për jetën e përditshme, siç janë shëndetësia, arsimit, shërbimet publike, biznesore e të tjera. Pra progresi i bërë është evident dhe kënaq strukturën politike, por shumë e mangët për pjesën më të madhe të shoqërisë", thotë Naim Rashiti.

DIALOGU ME SERBINË

Një obligim tjetër që Kosova akoma nuk e ka përmbushur nga dialogu me Serbinë i ndërmjetësuar nga BE-ja është themelimi i asociacionit të komunave me shumicë serbe. Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, i cili në vitin 2013 në cilësinë e kryeministrit nënshkroi marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, i rikujton Qeverisë së Kosovës siç thotë "obligimin e paplotësuar ndërkombëtar, që ka të bëjë me themelimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe".

Një njohës tjetër i zhvillimeve politike Blerim Burjani, thotë për DW se Kosova në dhjetëvjetorin e pavarësisë akoma është në një rrugëtim drejt konsolidimit të institucioneve shtetërore. "Sfidat kryesore të Kosovës mbeten forcimi i rendit dhe ligjit, në veçanti funksionimi i sistemit të drejtësisë, lufta kundër korrupsionit, nepotizmi, shtrirja e sovranitetit të plote në

veri të shtetit, themelimi i Focave të Armatosura, Implementimi i marrëveshjes për Asociacionin e Komunave Serbe, ratifikimi i demarkacionit me Malin e Zi, liberalizimi i vizave, zhvillimi ekonomik dhe mbrojtja shëndetësore dhe sociale dhe integrimet evropiane", thotë Blerim Burjani, duke shtuar se Kosova ka nevojë për një shtytje më të madhe nga BE në kuptimin e dhënies se vullnetit për proceset integruese.

"Pra BE duhet më shumë të inkurajojë dhe jep vullnet institucioneve të Kosovës për proceset integruese. BE duhet të përkrah më shumë qytetarët e Kosovës, ata kanë nevojë për përkrahje më të madhe nga BE që të mos jenë të izoluar nga Evropa. Qytetarët e Kosovës mbeten miq besnik të BE-së dhe të SHBA-së. Qytetarët e Kosovës besojnë fuqishëm në BE dhe zhvillimet e saj, sepse, kosovarët janë të përkushtuar në rrugën drejt integriteteve evropiane. BE duhet të ofroj më shumë vullnet për kosovarët", shprehet Blerim Burjani.

NISMA KUNDËR GJYKATËS SPECIALE - ACARIM I MARRËDHËNIEVE ME NDËRKOMBËTARËT

Në prag të shënimit të dhjetëvjetorit të pavarësisë, Kosova acaroi skajshmërisht marrëdhëniet me bashkësinë ndërkombëtare, kur 43 deputet të kuvendit të Kosovës ndërmorren një nismë për shfuqizimin e Gjykatës Speciale



NAIM RASHITI

Realiteti është që shoqëria kosovare nuk ka pasur përvojë në ndërtimin e institucioneve dhe nuk ka pasur një projektion se si do të ecin vitet e pavarësisë, si do të duket 10 vjeçari, 20 vjeçari i pavarësisë e kështu me radhë dhe premtimet që janë dhënë në atë kohë me shumë kanë qenë shprehëse sesa një realitet

për krime luftë, e themeluar me ligj nga kuvendi i Kosovës në vitin 2015. Debatet rreth kësaj çështje zgjatën më shumë se një muaj dhe vetëm pas një presioni të madh ndërkombëtar, udhëheqësit kryesorë të shtetit, Presidenti Hashim Thaci, kryetari i parlamentit Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj, u deklaruan publikisht se ligji për Gjykatën Speciale nuk do të shfuqizohet, edhe pse Gjykatën Speciale për krime luftë për Kosovën ata vazhdojnë ta cilësojnë si një padrejtësi historike. Për t'u siguruar që këto qëndrime janë të vërteta, me një deklaratë të përbashkët vendet e QUINT, ku bëjnë pjesë, SHBA-së, Gjermania, Franca, Italia dhe Mbretëria e Bashkuar,

KRIKUA NDAJ BE

Nga politika kosovare pati kritika ndaj strategjisë së BE-së, pjesa për Kosovën. Mirëpo, përfaqësuesja e BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova thotë se në thelb në strategji, "nuk ka ndonjë dallim ndërmjet Kosovës dhe vendeve të tjera të rajonit, ndonëse për Kosovën, ende mbetet rrugë e gjatë deri në fazën integruese". "Kushtet dhe kriteret janë të njëjta dhe procesi i zgjerimit mbetet i mbështetur në meritat dhe nuk ka rrugë tjetër. BE-ja nuk mundet dhe nuk do të importojë mosmarrëveshje bilaterale, ato duhet të zgjidhen para anëtarësimit. Kosova, e po ashtu edhe Serbia, duhet t'i intensifikojnë përpjekjet për normalizim, ngase nuk ka ndonjë rrugë alternative", u shpreh Natalya Apostolova.



mirëpritën qëndrimet e udhëheqësve politik kosovarë. "Presim nga udhëheqësit e Kosovës të mbajnë fjalën e tyre kurse nga institucionet e Kosovës presim që ta nderojnë këtë gatishmëri. Vetëm duke mbështetur sundimin e ligjit dhe duke siguruar drejtësi për të gjitha viktimat, Kosova mund ta afirmojë pjekurinë e saj si shtet dhe gatishmërinë për tu integruar tërësisht në Evropë dhe komunitetin ndërkombëtarë. Me mbështetjen e Dhomave të Specializuara mundësohet mbështetje e vazhdueshme nga miqtë dhe aleatët më të ngushtë të Kosovës tani kur festojmë shumë të arritura në dekadë, që nga pavarësia", thuhet në deklaratën e shteteve të QUINT.

PËRGJEGJËSIA E KLASËS POLITIKE

Një analist tjetër politik Imer Mushkolaj, i tha DW-së se para dhjetë vjetësh pritjet e qytetarëve nga shteti i tyre kanë qenë shumë më të mëdha. "Gjërat nuk kanë shkuar ashtu siç mendohej as në aspektin e shtet-ndërtimit, por as në fusha të tjera. Sot Kosova është një shtet më shumë probleme, për shumë kënd vend me perspektive të zymtë që më shumë iu shërben interesave të klasës politike, sesa të qytetarëve. Dhe përgjegjësinë për këtë gjendje e mban klasa politike e cila, me veprimet e veta, me qasjen e vet ka bërë që gjërat të ngecin", thotë Imer Mushkolaj.

Sipas tij, nuk është e lehtë që një shtet të bëhet, por me një përkushtim e përgjegjësi më të madhe të lidhshpimit politik, gjendja do të ishte shumë më mirë. "Serbia e ka penguar gjatë gjithë kësaj dekade shtet-ndërtimin e Kosovës. Nëse nuk arrihet marrëveshje finale për njohjen e shtetësisë së Kosovës, atëherë problemet vetëm sa do të shtohen. Marrëveshja ndërmjet dy shteteve duhet të arrihet sa më shpejt, me ndërmjetësimin dhe garancën e SHBA-ve dhe BE-së. Kjo do të ndikonte për mirë në shtet-ndërtimin e Kosovës", thotë Imer Mushkolaj.

PRITSHMËRITË E QYTETARËVE

Shumë qytetarë të Kosovës nuk janë të bindur se fundi i dialogut Kosovë-Serbi i ndërmjetësuar nga BE-ja do të prodhojë si rezultat që Serbia ta njohë pavarësinë e Kosovës. Në një hulumtim të opinionit të bërë nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), "Normalizimi i marrëdhënieve Kosovë-Serbi, këndvështrimi i qytetarëve", konstatohet se 49% e qytetarëve të mendojnë se dialogu Kosovë-Serbi nuk duhet të vazhdojë pa përfshirjen direkte të SHBA-ve në këtë proces. "Janë 45% e të anketuarve nga komuniteti serb që ndajnë qëndrimin se dialogu duhet të vazhdojë edhe pa përfshirje të SHBA-ve në këtë proces, kundrejt vetëm 29% të qytetarëve nga komuniteti shqiptar dhe 24% nga komunitetet e tjera të cilët mendojnë të njëjtën gjë".

E Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, thotë se "pavarësia e Kosovës është arritur në përpjekje të përbashkëta me SHBA-të dhe kjo e bën më të veçantë lidhjen mes dy popujve atij kosovar dhe amerikan. SHBA-të në krye të NATO-s ka shpëtuar jetët e qytetarëve të Kosovës", u shpreh kryeministri Ramush Haradinaj, që së bashku me Presidentin Hashim Thaçi ishin në SHBA për lutjet e mëngjesit.

"51% e qytetarëve të anketuar nuk presin që procesi i dialogut me Serbinë të përmbyllet gjatë vitit 2018. Qëndrim të ngjashëm ndajnë të gjithë qytetarët e anketuar pavarësisht përkatësisë së tyre etnike. (48%) janë përgjigjur se nuk presin njohje nga Serbia në përfundim të procesit të dialogut. "Vetëm 1% e qytetarëve të komunitetit serb presin që Serbia do të njohë shtetin e Kosovës në përfundim të këtij procesi, krahasuar me 34% të qytetarëve të komunitetit shqiptar dhe 23% e qytetarëve të komuniteteve të tjera", thuhet në hulumtimin e opinionit të bërë nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) "Normalizimi i marrëdhënieve Kosovë-Serbi, këndvështrimi i qytetarëve".



Të enjten, pas takimeve të kryeministrit malazez me Thaçin dhe Kadri Veselin, opinionin u njoftua se ishte arritur ujdia për nënshkrimin e një aneks marrëveshje, e cila parashihte miratimin e demarkacionit në ditët në vijim

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në një konferencë për media ka njoftuar se bashkërisht dhe në të njëjtën kohë me presidentin e Malit të Zi, Filip Vujanović, kanë dalë me një Deklaratë për ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi, njoftojnë media në Prishtinë. Përmes kësaj deklarate dy presidentët u kanë bërë thirrje deputetëve që ta votojnë marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet dy vendeve në gushtin e vitit 2015. Këtë marrëveshje e kishte nënshkruar Thaçi si zëvendëskryeministër dhe ministër i punëve të jashtme të Kosovës.

Kjo deklaratë e dy presidentëve erdhi pas vizitës dy ditëshe të kryeministrit malazez, Dusko Marković. Të enjten, pas takimeve të kryeministrit malazez me Thaçin dhe Kadri Veselin, opinionin u njoftua të ishte arritur ujdia për nënshkrimin e një aneks marrëveshje, e cila parashihte miratimin e demarkacionit në ditët në vijim. Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj ka thënë se në këtë jubile të Pavarësisë së Kosovës, jam i lumtur që sot u arrit aneks-marrëveshja për ratifikimin, rishikimin dhe korrektimin e demarkacionit me Malin e Zi. "Sot u vulos që sektorët në drejtim të Çakorrit dhe Zhlepit do të rishikohen dhe korrektohen", ka thënë Haradinaj. Sipas tij, dekla-

rata e përbashkët e Presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi dhe Presidentit të Republikës së Malit të Zi, Filip Vujanović, në formën e aneks-marrëveshjes si instrument ligjor obligativ ndërkombëtar, i jep epilog një paqartësie dhe ndarjeje të gjatë në shoqërinë tonë.

"Me këtë po përfundojmë obligimin e fundit për liberalizim të vizave dhe po hapim një kapitull të ri në lirinë e lëvizjes për qytetarët tonë. Urime Kosovë", ka thënë Haradinaj.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama ka përsëndetur arritjen e marrëveshjes për demarkacionin mes Kosovës dhe Malit të Zi. Rama në një postim në Facebook ka njoftuar se është duke ardhur në Prishtinë për 10 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës dhe ka uruar që demarkacioni të mbyllet sa më parë. "Rrugës për Prishtinë ku sapo dëgjova për hapin e rëndësishëm drejt finalizimit të demarkacionit me Malin e Zi! Uroj të mbyllet sa më parë", ka shkruar ai.

Shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së, Avdullah Hoti ka folur lidhur me deklaratën e përbashkët të presidentit të vendit, Hashim Thaçi dhe homologut të tij, Filip Vujanović lidhur me Demarkacionin me Malin e Zi. "Vlerësojmë se është humbur shumë kohë, tri vite me debate të kota për këtë marrëveshje dhe tash po kthehemi në pikën zero. Marrëveshja duhet të ratifikohet sa më parë në Kuvend". "Këta që e kanë bllokuar deri tash këtë çështje dhe kanë mbajtur qytetarët e izoluar duhet të japin përgjegjësi para qytetarëve të vendit". Pas arritjes së marrëveshjes me Malin e Zi për demarkacionin Partia Demokratike ka mbajtur konferencë për media. Nënkryetari i PDK-së, Enver Hoxhaj ka thënë se kjo parti përsëndet këtë marrëveshje dhe përgëzon presidentët për një deklaratë të tillë, raportojnë mediat kosovare



Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama ka përsëndetur arritjen e marrëveshjes për demarkacionin mes Kosovës dhe Malit të Zi. Rama në një postim në Facebook ka njoftuar se është duke ardhur në Prishtinë për 10 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës dhe ka uruar që demarkacioni të mbyllet sa më parë Ai ka thënë se është meritë e bashkëpunimit dhe lidhshpimit brenda koalicionit për marrëveshjen.

MICHAEL ROTH DEKLAROHET I PRERË

Lëvizjet e kufijve janë tejet të rrezikshme



Qeveria e Gjermanisë konsideron që një marrëveshje e mundshme mes Kosovës dhe Serbisë duhet të gjendet nga të dyja palët me pjesëmarrjen e Bashkimit Evropian, por kundërshton kategorikisht

që në kërkimin e zgjidhjes të dyja vendet të lëvizin kufijtë mes vete.

Kështu thotë Michael Roth, ministër i Shtetit për Evropë në Ministrinë e Jashtme gjermane.

"Unë nuk do t'i ofroja asnjëherë palë propozime konkrete nga jashtë, sepse çështjet që ju përmendni janë shumë komplekse dhe sigurisht aspak të thjeshta për t'i zgjidhur. Mirëpo, përgjithësisht unë kam besim që Kosova dhe Serbia do të tejkalojnë këtë pengesë, nëse për këtë ka vullnet politik. Ndonëse këtu më duhet të shpreh një paralajmërim: lëvizjet e kufijve janë tejet të rrezikshme. Ne i kundërshtojmë ato në mënyrë kategorike", ka

thënë Roth në një intervistë ekskluzive për "Kohën Ditore", dhënë me rastin e 10-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë.

Zyrtari i lartë gjerman, po ashtu, përmend edhe incidentet e fundit që tensionuan marrëdhëniet mes Kosovës dhe vendeve përkrahëse të pavarësisë, duke theksuar se problemet e vendit "para së gjithash janë të vetëshkaktuara". "Kosova do të ketë sukses si shtet vetëm kur të respektohen parimi i shtetit ligjor dhe obligimet ndërkombëtare për trajtimin e krimeve të luftës. Për këtë shkak, përpjekjet për të sabotuar Dhomat e Specializuara janë tejet të dëmshme edhe për raportet e Kosovës me partnerët e saj", tha Roth.



Artistët i kundërvihen Kryeministrit

Menjëherë pas deklaratave të djeshme të Kryeministrit Edi Rama lidhur me Teatrin kombëtar, kanë reaguuar aktorët e këtij institucioni dhe janë shprehur se ditën e sotme do të dalin në një deklaratë për shtyp. Kreu i Sindikatës së Aktorëve të Teatrit Kombëtar, Arben Derhemi tha se nuk ka më kuptim pritja për një takim të ministres Kumbaro, dhe nëpërmjet një deklaratë për shtyp ne do t'i japim një përgjigje Kryeministrit karshi gjuhës dhe fjalorit që ai përdori ditën e djeshme në parlament.

Derhemi i revoltuar ka thënë se vetë ministrja e Kulturës i ka premtuar atyre se Teatri nuk do të priset dhe nëse do të arinin të kishin një kompromis mes palësh, në vend të Teatrit nuk do të ndërtohej asgjë tjetër veçse një Teater me kushte Europiane. "Tashmë, pritja për takim në ambientet e Teatrit nuk ka më kuptim, ministrja e Kulturës Mirela Kumbaro premtoi publikisht se në këtë territor nuk do të ndërtohet veçse teatër dhe ramë dakord që nuk do të lëvizim prej këtej. Ndërkohë, përfaqësuesit tanë do të ulen në tryezë me të, për të diskutuar projektligjin. Por përmes një deklaratë ne do t'i përgjigjemi qëndrimit të Kryeministrit karshi artistëve, për gjuhën e përdorur prej tij në komentet e fundit për shqetësimet e artistëve", tha Derhemi, duke shtuar se do t'i qëndrojnë deri në fund vendimit të tyre për të mos u larguar nga ai teatër, pa parë projektin e ri, që në mendimin e tij personal, do të ishte më e arsyeshme ruajtja e fizionomisë së teatrit ekzistues, duke respektuar kështu historinë gati 70-vjeçare të këtij institucioni.

"PANTERA E ZEZË" NË SHKUP



Kompania nga Maqedonia për animacion dhe efekte vizuale Fx3x mori pjesë në krijimin e efekteve vizuale në filmin më të ri të Universit të Marvelit "Pantera e Zezë", i cili mbrëmë pati premierë në Shkup. Ky është filmi i 18-të i Universit të Marvelit, me regji të Rajan Kugler, ndërsa skenari është i Xhoi Robert Koll.

Sipas Kristian Danillovskit, bashkëpronar i Fx3x dhe producent ekzekutiv, në këtë projekt kanë punuar gjithsej 105 artistë nga shtatori deri në dhjetor të vitit të kaluar.

"Këtë projekt e punuam në bashkëpunim me Metod studios Vankuver dhe në film janë punuar rreth 200 kuadro, ndërsa si

fansa të serisë me padurim prisnim ta shohim në tërësi. Nga redaktori ekzekutiv të Fandagos, Erik Dejvis, faqja më e popullarizuar për blerje të biletave për në kinema, përmes Tuterit kuptojmë se 'Pantera e zeze' i ka tejkaluar të gjithë rekordet në biletat e shitura në shitje para-premiere, dhe e ka tejkaluar rekordin e deritanishëm të Marvelit 'Kapiteni Amerika: Lufta Civile' nga viti 2016 për më pak se 24 orë. Për efektet vizuale lë që të shikoni dhe vetë të vlerësoni", deklaroi Danillovski.

Sipas tij, duke pasur parasysh se premiera u paralajmërua me TV spot me muzikë nga Kendrick Lamar dhe Uins Stejpëlls, as mu-

zika nuk do ta lërë indiferent publikun.

"Pantera e Zezë" është film për superhero, vazhdim i "Hakmarrësit: era e Ultronit" dhe "Kapiteni Amerika: Lufta Civile", me të cilin Marvel e hapi vitin 2018 në të cilin e kremton dhjetëvjetorin nga puna e saj.

Premiera e filmit "Pantera e Zezë" u mbajt më 29 janar në Los-Anxhelos, ndërsa me shfaqjen nëpër sallat e kinemasë në Amerikë do të fillojë nesër. Kritikë të cilat i mori janë të shkëlqyeshme dhe është filmi superhero me kritika deri tani më të mira në sajtin Roten Tomatos, duke e tejkaluar The Incredibles nga viti 2004.



Në New York, Gala Koncert për nder të Nexhmije Pagarushës

Me rastin e 17 shkurtit, 10 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, para komunitetit shqiptar në New York u mbajt një gala koncert, organizuar dhe ideuar nga fotografi i njohur shqiptar Fadil Berisha. Koncerti përmbante këngë të artistes së mirënjohur Nexhmije Pagarusha, të interpretuara nëpër vite nga këngëtarë të njohur shqiptarë. Vet Fadil Berisha ka thënë se ka qenë ide e mëhershme e tij të sillte të rikomponuara këngët e Pagarushës, gjë që vite më parë u interpretuan në një koncert tjetër nga këngëtarja Aurela Gaçe. Para publikut u paraqitën Linda Halimi, Riad Ymeri, Ergin Oda, Dëshira Ahmeti, Angelo Miho, Agona Shporta, Donika Ukshini Ukaj, Elona Muça, Gjilberta Lucaj, Gjon Krasniqi, Igli Tuga, Lekç Salihu, Lindita Mezini Lole, Lori Miho, Mialtin Zhezha dhe Pia Salvia. Ky koncert është mbështetur edhe nga konsullata e Republikës së Kosovës në Neë York, e vecanërisht nga Konsullja e këtij institucioni – ambasadorja Teuta Sahatqija. Në këtë koncert ishte paraparë që të ishte prezente edhe vetë Nexhmije Pagarusha, por në pamundësi për të marrë këtë rrugë të largët, ajo nuk do të jetë e pranishme në këtë koncert.

"Një ëngjëll në katin e 11", komedi urbane në Metropol

Komedia "Një ëngjëll në katin e 11" shkruar dhe me regji nga Stefan Çapaliku erdhi premierë në skenën e Teatrit të Metropolit për publikun. Kjo është dhe premiera e parë për këtë sezon artistik të këtij viti, që u çel me një vepër shqiptare. Rolet në vepër regjisori ia ka besuar aktorëve Ervin Bejleri, Ilirida Bejleri, Erjon Hinaj. "Një ëngjëll në katin e 11" është një ndër 25 veprat dramatike të Stena Çapalikut, e cila shënon një ngjarje në estetikën e veprave të veta, duke i hapur shteg dramaturgjisë së mbështetur në ngjarjet e mendjes. Një komedi urbane që sipas regjisorit i kalon kufijtë të postmodernes drejt asaj që thirret estetikë e artit bashkëkohor, duke kërkuar kështu edhe një gjuhë teatrorë ba-



shkëkohore. Në vepër sipas tij janë realitete paralele.

Ngjarjet e shfaqjes zhvillohen në një stacion treni, gjatë natës. Askush përveç dy udhëtarëve të rastësishëm dhe më pas, si çdo njohje tjetër, edhe kjo, mediokre. Një apartament në katin e njëmbëdhjetë. Një çift po bën da-

shuri. Telefoni ndërpret flirtin e tyre: burri i saj do të arrijë nga çasti në çast. Djali do t'ia mbathë, por ashensori është jashtë funksionit. Nëse merr shkallët, rrezikon të ndeshet me fytyrën e burrit. As nuk mund të hidhen nga dritarja. Pikërisht në çastin kur ai mendon, kur koha mbaron. Ka një

trokitje në derë. Në vend të burrit, shfaqet një dëshmi e Jehovahit, duke mbajtur një Bibël në dorë. Atij po i merret fryma nga shkallët dhe nuk ndihet mirë. I riu dhe gruaja i japin atij ndihmën e parë. Dëshmitari i Jehovahit, vjen në vete dhe fillon një fjalim patetik rreth familjes. Dhe si për të dashur t'i japë me të vërtetë fund fjalimit të vet, ai vdes. Dashnorët e vendosin atë në shtratin e tyre dhe fillojnë të flasin për jetën e vet. Ndërkaq, burri që pritët nuk vjen kurrë. Ai është thjesht një fiksim i mendjes së tyre të lodhur nga rutina e një marrëdhënie banale. Sërish një stacion treni natën. Askush në të përveç dy udhëtarëve të rastësishëm dhe më pas, siç do njohje tjetër, edhe kjo, mediokre.

Koha, e shtunë 17 shkurt, 2018

LIGA E PARË, JAVA E 20-të

SHKUPI I GATSHËM PËR SHKËNDIJËN

Futbollistët e të dyja skuadrave synojnë të vazhdojnë me rezultatet e mira, ku fitorja mbetet imperativ duke i marr parasysh synimet që i kanë

JAVA E 20, TAKOHEN:
RENOVA - SILEKSI
A.PANDEV - SKOPJE
PELISTERI - RABOTNIÇKI
VARDARI - POBEDA
SHKUPI - SHKËNDIJA

ndeshje në vete sjellë kundërshtarë të ndryshëm. Ndeshja e së dielës mendoj se do të jetë një derbi i vërtet, edhe pse nëse marr besimin e trajnerit do të jetë derbi i parë dhe debutimi im i parë në ndeshje zyrtare. E kemi parasysh se luajmë ndaj ekipit që është lider dhe dëshiron titullin e kampionit, por edhe ne kemi synimet tona dhe kërkojmë gjithsesi të marrim më të mirën e mundshme. Do të luajmë para tifozëve tanë dhe shpresoj të jenë kushtet e mira në terren me një korrektësi maksimale të mirëpresim Shkëndijën, ndërsa në fund shpresoj që ti gëzojmë tifozët tanë", deklaroi Broja. Në anën tjetër, braziliani në radhët e Shkëndijës, Stenio Zhunior pohon se në Shkup vijnë për të marr rezultatit e dëshiruar. "Gjithmonë është një ndeshje e vështirë, e dimë se FC Shkupi në këto momente gjithashtu kërkon rezultate të mëdha, mirëpo Shkëndija çdo ditë është më e fortë dhe me shumë dëshirë për të dalë kampione në këtë sezon. Atmosfera në skuadër është e mrekullueshme për të shkuar në Shkup me bindje për

të bërë një ndeshje të madhe dhe për të marrë rezultatit e dëshiruar. Çdo ndeshje është histori ndryshe, prandaj ne gjithmonë kërkojmë të jemi të fortë dhe në nivel të mirë për të dalë me sukses nga ndeshje të këtilla derbi", deklaroi për KOHA, Zhunior. Ndërkohë, nën hije të derbit shqiptar, në kuadër të javës së 20-të të dielën do të zhvillohen edhe katër përballje tjera ku veçohet përballja mes Renovës dhe Sileksit, derisa kampioni aktual Vardari do të pret Pobodën. Të gjitha ndeshjet e javës së 20-të në LPFM-së do të zhvillohen të dielën në ora 14.00.

Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 16 shkurt - Java e 20 e Ligës së parë futbolistike e Maqedonisë në fundjavë sjell edhe një derbi, pas asaj në mesjavë ku Shkëndija në stadiumin e qytetit në Tetovë u përball me Vardarin (1-1). Në "Boris Trajkovski" në lagjen Maxhari, FC Shkupi do të pret liderin aktual dhe favoritin më të madh për titull, KF Shkëndija. Atmosfera në të dyja taborët është e mirë, sidomos te FC Shkupi, e cila në sezonin pranveror e filloi në mënyrën më të mirë të mundshme, kur me 5-2 mundën Akademija Pandevin, derisa skuadra tetovare luajti baras me Vardarin, duke ruajtur kështu epërsinë kundrejt saj prej tetë pikëve. Futbollistët e të dyja skuadrave synojnë të vazhdojnë me re-

zultatet e mira, ku fitorja mbetet imperativ duke i marr parasysh synimet që i kanë. Ndryshe, për FC Shkup ndaj Shkëndijës pritet për herë të parë në një ndeshje zyrtare të debutojnë Ron Broja dhe Shtefan Vujiç, pasi të dytë nuk luajtën ndaj Akademija Pandevit, derisa afrimet e fundit si Emre Xhan Atila, Toni Tipuriç dhe Valentin Kočovski, nuk do të jenë në kombinim, pasi të njëjtit nuk kanë kompletuar dokumentacionin e nevojshëm dhe debutimi i tyre pritet të ndodhë në ndeshjen e ardhshme ku Shkupi do të jetë mysafir i Pobodës. I lumtur që do të debutojë në fanellën e FC Shkupit është kosovari Ron Broja. "Para se gjithash dua të flas për atë se jam shumë i lumtur që ekipi ynë filloi sezonin me fitore. Për mua do të jetë shumë me rëndësi që të vazhdojmë me ritëm të këtillë edhe pse secila

Trajneri i Kosovës pritet të jetë francez?

Përfaqësuesja e Kosovës në futboll që nga largimi i Albert Bunjakit nga posti i përgjydhësit, ende nuk e ka zgjedhur të riun, por këtë detyrë e kryen ish futbollisti i mirënjohur Muharrem Sahiti. Burimet jozyrtare bëjnë me dije se Federata e Futbollit e Kosovës, është në negociata me një trajner

francez. Mbetet të shihet se vërtet do të vijë një francez në krye të Kosovës apo dikush tjetër. Sipas burimeve, Fadil Vokrri, kryetar i FFK-së, me ekipin e tij janë duke biseduar me një trajner francez. Fundja, së shpejti pritet FFK të publikojë edhe emrin e përgjydhësit të ri.



RENDITJA E UEFA-së

Vardari përparon 54 vende, e ndjek Shkëndija

Shkup, 16 shkurt - UEFA ka bërë publike renditjen e saj më të fundit, për klube në të cilën skuadra e Vardarit ka shënuar një ecje para për plotë 54 vende.

Kampioni aktual në sezonin e kaluar mbante pozitën e 255, ndërsa falë paraqitjeve në garat e Liga Evropës dhe eliminatorët për Ligën e Kampionëve, tani mbajnë pozitën e 201-të.

Rekordin e skuadrës më mirë të renditur nga Maqedonia e mbante Rabotnički nga sezoni 2011/12 kur mbante pozitën e 205. Në këtë renditje janë edhe tetë



skuadra vendore. Shkëndija e mban pozitën e 278 dhe pasojnë Rabotnički, Pelisteri, Sileksi e Renova që mban pozitën e 366, për të vazhduar me Metalurgun, Horizontin dhe Teteksin.

FSHF REAGON PËR SKËNDERBEUN

Ende propozime, çështja i takon ekipit dhe UEFA-s

Federata Shqiptare e Futbollit ka reaguar në lidhje me raportin e inspektorëve të UEFA-s sa i përket çështjes Skënderbeu. Nëpërmjet një komunikate për shtyp, qeveria e futbollit në vend ka bërë të ditur se është vënë në dijeni në lidhje me

dokumentin që i është drejtuar Komisionit të Disiplinës dhe shtoi se bëhet fjalë për një relacion të inspektorëve të UEFA-s dhe jo për një vendim disiplinor. Në të njëjtën kohë, FSHF theksoi se po e ndjek me vëmendje këtë çështje, duke sh-

tuar se është diçka i përket drejtpërdrejt Skënderbeut dhe UEFA. Në të njëjtën kohë, Federata Shqiptare e Futbollit bëri të ditur se do të jetë hapur ndaj çdo vendimi disiplinor që mund të vijë në rrugë zyrtare nga UEFA për rastin e Skënderbeut.



“TRULLOSET” NGA OFERTA KINEZE

Ky mund të jetë një nga operacionet e mëdha të tregut të verës së ardhshme. Andres Iniesta tashmë ka në tryezë interesin formal të Tianjin Quanjian, skuadrës së Superligës Kineze. Propozimi është me të vërtetë joshës në planin financiar dhe mund të arrijë në 35 milionë euro, pa biletën e sezonit, diçka që po e bën të meditojë seriozisht Iniestën për të ardhmen e tij të afërt. Përfaqësuesit e klubit kinez tashmë kanë qenë në Spanjë, në dy raste, dhe kanë filluar të planifikojnë operacionin, por futbollisti Blaugrana nuk ka marrë vendim. Ai do të presë deri në fund të marsit për të dhënë një përgjigje, por klubi kinez është optimist për momentin. Kontaktet me Iniestën filluan në fund të dhjetorit dhe pati një “samit” të parë në fillim të janarit. Ishte thjesht një takim njohjeje, në të cilin ishte e qartë se Iniesta do ta linte veten të hapur në verë dhe kurrë në merkaton e dimrit. Në një takim

të dytë, me dokumentacion tashmë, Tianjin shpali rrugën për të arritur të njëri nga yjet e futbollit botëror. Iniesta është i vetëdijshëm se nuk do të marrë një ofertë të fuqishme ekonomikisht nga ndonjë kampionat tjetër. Madje, është ndoshta e vetmja mundësi e tij e madhe për t'u bërë një nga lojtarët më të paguar në planet, por ende ka dyshime. Mesfushori ka një sezon të mirë dhe ndihet mirë fizikisht. Tani ai ka vërtetuar se, pavarësisht nga nënshkrimi i Kutinjos, vazhdon si titullar dhe Ernesto Valverde po e hedh në lojë në ndeshjet e komplikuara. Vendimi i tij përfundimtar do të varet nga fakti se si do të përfundojë sezoni dhe pastaj mund të peshojë aspektin sportiv. Te Barça janë plotësisht të vetëdijshëm për lëvizjet e futbollit kinez dhe supozojnë se do të jetë shumë vështirë të mbahet Iniesta. Në fakt, klubi Blaugrana nuk do ta pengojë lojtarin, ashtu siç bëri në kohën e tij me Çavi Hernandezin. Pra, do të respektojë vendimin e tij, pas karrierës së shkëlqyer në klub. Iniesta, gjithashtu, ka marrë interesin e një ekipi të MLS dhe të futbollit arab, por mendon vetëm kalimin në Kinë, ose të qëndrojë në ekipin Blaugrana.

UILLIAMS PREZANTON MAKINËN E RE

Pilotët Lance Stroll dhe Sergej Sirotkin do të zbresin në pistë sezonin e ri të Formula 1 me objektivin për t'u ngjitur në podium. Makina britanike ka bërë dje prezantimin e saj, skuadra e dytë që paraqitet për mediat pas Haas. Inxhinierët, të drejtuar nga shefi Paddy Love kanë punuar fort për të eliminuar mungesën e ngarkesës aerodinamike së vërejtur sezonin e kaluar edhe pse në disa gara Uilliams është ngjitur në podium. Ndërkohë që, spikat prania e “halo”, pjesa mbrojtëse e vendosur te koka e pilotit, një masë e detyrueshme këtë vit. Si Stroll

ashtu dhe Sirotkin do të kenë në dispozicion fuqinë e motorit Mercedes për t'ia dalë mbanë, ndërsa Kubica do të bëjë rolin e kolaudatorit këtë sezon. “Ishim kuriozë për të parë makinën e re, por jemi të kënaqur, pasi është punuar fort për të përgatitur një makinë sa më kompetitive. Jemi të kënaqur me sfidën e re dhe jemi stërvitur për të qenë gati për fillimin sezonin e ri. Viti 2017 ka qenë i rëndësishëm për mua, kam fituar përvojë dhe shpresoj që këtë sezon të jem edhe më kompetitiv”, tha Lance Stroll, në sezonin e dytë me Uilliams.



Publicitet

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune dhe nenit 82 paragrafi 3 i Ligjit për arsim fillor, SHF “Dame Gruev” – Manastir publikon

SHPLLJE

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në vitin shkollor 2017/2018 për kohë të caktuar të punës deri më 31.08.2018

- mësimdhënës të etikës së religjioneve 10 orë mësimore me pagesë fillestare prej 9.900,00 den.
 - mësimdhënës të aftësive të jetesës 10 orë mësimore me pagesë fillestare prej 9.900,00 den.
 - mësimdhënës të matematikës 5 orë mësimore me pagesë fillestare prej 5.700,00 den.
 - mësimdhënës të edukatës muzikore 6 orë mësimore me pagesë fillestare prej 6.200,00 den.
 - mësimdhënës të arsimin teknik 11 orë mësimore me pagesë fillestare prej 10.000,00 den. zëvendësim për mësimdhënës në pushim të lindjes
 - mësimdhënës të informatikës 10 orë mësimore me pagesë fillestare prej 9.900,00 den. zëvendësim për mësimdhënës në pushim të lindjes.
 - mësimdhënës të gjuhës maqedonase 20 orë mësimore me pagesë fillestare prej 19.800,00 den. zëvendësim për UD Drejtorin.
 - mësimdhënës të mësimin klasar 20 orë mësimore me pagesë fillestare prej 19.800,00 den. zëvendësim për mësimdhënës në pushim mjekësor
 - një mirëmbajtës të higjienës me orar të plotë të punës zëvendësim për punëtorin në pushim të mjekësor me pagesë fillestare 12.300,00 den.
- Orari i punës së mësimdhënësve është me dy ndërrime prej ora 7,30 ndërrimi i parë dhe prej ora 13,00 ndërrimi i dytë, ndërsa përfundon me përfundimin e orëve në pajtim me Programin vjetor për punë të shkollës.
- Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e parapara në Ligjin për arsim fillor për kuadrin mësimor.
- Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.
- Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve.
- Për njohje të gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik do të mbahet testim për të cilin enkas do të informohen.
- Lutjet së bashku me dokumentet e nevojshme (Diplomë për arsim të mbaruar dhe Certifikatë të shtetësisë) parashtrihen në SHF “Dame Gruev” Manastir, rr. “Gjorçe Petrov” nr. 7 Manastir.

SHF “Dame Gruev” Manastir

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 167/2015 dhe 27/2016), nenit 79-d të Ligjit për arsim fillor, ndërsa në lidhje me Pëlqimet e lejuara për punësim për kohë të caktuar të punës për vitin shkollor 2017/2018 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës nr. 12-12701/7 të datës 25.01.2018, SHFK “Krumë Kepeski”, komuna e Kisella Vodës – Shkup publikon

SHPLLJE PUBLIKE

SHFK “Krumë Kepeski”, komuna e Kisella Vodës – Shkup ka nevojë për themelimit të marrëdhënies së punës për kohë të caktuar me punëtorë për vendet e punës në vijim:

- Nëngrupi I niveli A1 drejtues të kotleve për ngrohje, shifra e vendit të punës OBN 04 01 A01 003 – një (1) realizues**
- Kushtet e përgjithshme
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
 - Të jetë i moshës së rritur,
 - Të ketë të mbaruar arsimin fillor/të mesëm
- Orari i kohës së punës
- Ditët e punës e hënë – e premtë
 - Orët e punës në javë 40
 - Orari i punës prej ora 06:30 deri në ora 14:30
- Neto shuma e pagesës në të holla: 14.810,00 denarë
- Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrijnë:
- Lutje;
 - Kopje të letërnjoftimit;
 - Dëshmi për arsim të mbaruar (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter);
 - Certifikatë të shtetësisë (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter);

Afati për parashtrimin e dokumenteve është pesë (5) ditë nga dita e publikimit të shpalljes. Vendimi për zgjedhje do të realizohet në afat prej 45 ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit dhe i pakompletuar nuk do të shqyrtohet. Dokumentet të parashtrihen në adresën SHFK “Krumë Kepeski” – Shkup, rr. “Hristo Tatarçev” nr. 46 Shkup.

I nr. 1823/2017

SHPLLJE PUBLIKE
(në bazë të nenit 48 paragrafi 2 i Ligjit për përbarim Gazeta Zyrtare nr. 72 e datës 12.04.2016)

Përbaruesi Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari në bazë të kërkesës për realizim të përbarimit nga kreditori Univerzalna Investiciona Banka SHA Shkup nga Shkupi me seli në rr. Maksim Gorki nr. 6, bazuar në dokumentin përbarues ODU nr. 1747/13, ODU nr. 1748/13 të datës 15.11.2013 të Noter Sebaedin Dauti – Gostivar, kundër borxhlinjeve 1. Xhezmi Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë 2. Gjuzazije Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë, 3. Fatime Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë dhe borxhliu pengmarrës Shukrije Mulai nga Gostivari me seli në rr. Nikolla Parapunov nr. 236, për realizim të përbarimit në vlerë prej 12.064.787,00 den., më datë 12.02.2018:

FTON
Borxhlinjtë Xhezmi Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë, Gjuzazije Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë, Fatime Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë dhe borxhliu pengmarrës Shukrije Mulai nga Gostivari me seli në rr. Nikolla Parapunov nr. 236 për shkak të dorëzimit të:

Konkluzionit për shtyrje të përbarimit në bazë të nenit 91 paragrafi (1) të LP I. nr. 1823/2017 të datës 15.01.2018 të Përbaruesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari në afat prej 1 (një) dite duke konsideruar nga dita e publikimit të kësaj thirrje publike në mjetet e informimit.

PARALAJMËROHEM borxhlinjtë Xhezmi Emro, Gjuzazije Emro, Fatime Emro dhe borxhliu pengmarrës Shukrije Mulai, se mënyra e këllitë e parashtrimit konsiderohet si e dorëzimi i rregullt dhe se pasojat negative që mund të dalin i bartë vet pala.

Kjo paraqet SHPLLJEN E TRETË.

Përbarues
Aleksandar Kuzmanovski

I. Nr. 324/2014

SHPLLJE PUBLIKE
(në bazë të nenit 46-b, të Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për përbarim, Gazeta Zyrtare nr. 8 të datës 17.01.2008)

Përbaruesi Vanço Markovski duke vepruar me propozim të kreditort Eshref Ajruli, përmes aut. avokatit Branko Trajkovski nga Tetova dhe vendbanim në rr. Drenoc – Poroj nr. 8, kundër borxhliut Husein Memedi nga Tetova me NVAQ dhe vendbanim në rr. Lubo Bozhinovski Pish nr. 69, dhe borxhliut pengmarrës Imer Shaqiri nga Tetova me NVAQ dhe vendbanim në rr. Lubotenska nr. 69 në Tetovë, për shkak të realizimit në holla në shumë prej 24.600.000 denarë më datë 15.02.2018

FTON
Borxhliut pengmarrës Imer Shaqiri nga Tetova me NVAQ dhe vendbanim në rr. Lubotenska nr. 69 në Tetovë të paraqitet në zyrën e përbaruesit Vanço Markovski në rr. Ilindenska nr. 64 Tetovë, për parashtrim të akteve në vijim: procesverbal I, nr. 324/2014 të datës 19.12.2017, të përpluar në bazë të nenit 94 paragrafi 8 të LP, Procesverbalin për zbrazjen dhe dhënien në pronësi të patundshmërisë I, nr. 324/2014 të datës 19.12.2017, të përpluar në bazë të nenit 226 paragrafi 1 dhe 189 paragrafi 3 të LP, Procesverbal për shtypin publike me gojë I, nr. 324/2014 të datës 07.02.2018, të përpluar në bazë të nenit 175 paragrafi 4 nga LP, Konkluzion për shtypin e dytë publike me gojë I, nr. 324/2014 të datës 07.02.2018, Konkluzion për përcaktimin e vlerës për shtypin e dytë I, nr. 324/2014 të datës 07.02.2018, NË AFAT PREJ 1 (NJË) DITE, duke llogaritur nga dita e publikimit të fundit të kësaj thirrje publike në shtypin ditor.

PARALAJMËROHEM borxhliu pengmarrës Imer Shaqiri se mënyra e këllitë e dorëzimit llogaritet si dorëzimi i rregullt dhe se për pasojat negative që mund të dalin i bartë vet pala.

Kjo shpallje paraqet PUBLIKIMIN E PARË të thirrjes publike

PËRMBARUES
Vanço Markovski

Koha <http://www.koha.mk> Search

E përditshme informative

Koha

www.koha.mk
koha@koha.com.mk | marketing@koha.com.mk
Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 060;
Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasje lok.14 - përdheshë, Shkup

NGA RICIKLIMI I PLEHRAVE TE KATERINGU

JA BIZNESET E PRESIDENTËVE TË SERISË A

Aurelio De Laurentis, përveç Napolit, ka dhe një tjetër pasion që është kinemaja. Presidenti napolitan është emri më i njohur italian në fushën e prodhimit dhe shpërndarjes së filmave



Sot njihen si presidentët e klubeve të tyre, po përpara se të vinin duart mbi klubet e Serisë A, të gjithë e kanë nisur diku karrierën e tyre. Çfarë kanë bërë, nga vijën dhe si e kanë ngritur pasurinë e tyre, janë këto pyetjet që është munduar t'i japë përgjigje në një artikull të saj "Gazzetta dello Sport".

Klaudio Lotito (Lacio)

Biznese në pastrim dhe catering, fushë në të cilën ka fituar disa nga tenderët më të kushtueshëm në legjislaturën e parafundit italiane.

Mario Konjini (Fiorentina)

Emërimi i tij ishte disi surprizë, sidomos pasi Fiorentina i përket familjes Dela Vale. Prej më shumë se 30 vitesh presidenti vjollcë është marrë me konsulencë financiare. Pasuria e tij e rendit të 1088 në

rang botëror, ndërsa si italian është "vetëm" i 23-ti.

Luka Kampedeli (Kievo)

Sipërmarrës i njohur, sot ai është aksionari më i madh i kompanisë "Paluani". Me 25 vite në krye të klubit (që nga Seria C), ai është një nga presidentët më jetëgjatë të Serisë A.

Aurelio De Laurentis (Napoli)

Aurelio De Laurentis, përveç Napolit, ka dhe një tjetër pasion që është kinemaja. Presidenti napolitan është emri më i njohur italian në fushën e prodhimit dhe shpërndarjes së filmave.

Andrea Anjeli (Juventus)

Pinjulli i Anjelëve ka biznese

në fusha të shumta dhe, përveç Juventusit, administron edhe "Exor" një nga shoqëritë më të mëdha aksionare në Europë.

Enriko Preciosi (Xhenoa)

Themelues në garazhin e tij i kompanisë së lodrave "Giochi Preziosi", e cila sot është vetëm një pjesë e "Fingiochi", një kolos ndërkombëtar në industrinë e lodrave. Në botën e futbollit hyri në vitin 1993, kurse në vitin 2003 vendosi të blinte Xhenoan.

Masimo Ferrero (Sampdoria)

Pasurinë e fitoi falë bashkëshortes, Laura Sini, por rritjen e saj e bëri me nuhatjen e tij. Sot, ndër të tjera, Ferrero zotëron 30 kine-

ma dhe ka provuar pa sukses fatin edhe në kompani fluturimesh.

Oreste Vigorito (Benevento)

Numri një i ekipit nga provinca e Napolit është një avokat, i cili ka dy diploma në filozofi dhe letërsi. Në 1993 themeloi "Italian Vento Power Corporation", një shoqëri që sot vlen 80 milionë euro.

Xhoi Saputo (Bolonja)

Kanadez, por me origjinë të dukshme italiane, presidenti kuqeblu është shumë aktiv në industrinë e pasurive të patundshme dhe zotëron ekipin e Montreal Impact. Që nga 2015, familja Saputo është mes treqind familjeve më të pasura në botë me 5 miliardë dol-

larë.

Erik Thohir (Inter)

Aksionar minoritar i Interit, përmes aktivitetit familjar, ai ka një pasuri personale që i kalon 4 miliardë dollarët, duke qenë njeriu i 421-të në botë për sa i përket pasurisë.

Jonghong Li (Milan)

Presidenti kuqezi ka ngritur pasurinë e tij në fushën e ndërtimit dhe minierave ku drejton "Guizhou Fuquan Group", një kompanie e specializuar në nxjerrjen e fosforit.

Xhejms Palota (Roma)

Drejtues i një fondi investimesh, presidenti verdhekuq është mes 100 njerëzve më të pasur në botë me 7.5 miliardë dollarë në llogarinë e tij.

Xhani Vrena (Krotone)


Krotonez dhe tifoz i çmendur i ekipit, të cilin sot e ka nën pronësi, përveç karrierës si sipërmarrës, ndër biznese të tij janë edhe disa kompani që merren me riciklimin e plehrave.

Antonio Perkasi (Atalanta)

Presidenti i Atalantës, dikur futbollist, pikërisht me fanellën e bergamaskëve, sot është presidenti i "Odisea Srl". Në vitin 1976 nisi karrierën si biznesmen dhe ndër vite ka futur në Itali dhe dy kolosë të veshjeve si Benetton dhe Zara me pasurinë e tij që sot vlerësohet rreth 800 milionë euro.

Bajerni i bashkohet garës për Ikardin

Mauro Ikardi është në shënjestër jo vetëm nga Manchester Junajtedi, Paris Sen-Zhermeni dhe Real Madridi, por edhe Bajerni Munihi, pasi Interi përpjetë të nxitojë një kontratë të re. Repreruesi argjentinas ka një klauzolë lirimi në marrëveshjen e tij aktuale me vlerë 110 milion euro, megjithëse thuhet se mund të aktivizohet vetëm për një periudhë të shkurtër në mes të majit dhe qershorit. Real Madridi, PSZH dhe Junajted kanë qenë të lidhura fort me një transferim për "vrasësin" argjentinas gjatë verës së ardhshme. Por, mediet italiane raportojnë se garës për shërbimet e kapitenit të Interit i është shtuar edhe një skuadër e madhe evropiane. Sipas mediumit kredibil pranë Interit, "FCInterNews.it", Bajerni Munihi gjithashtu kanë bërë një qasje fillestare drejt Ikardit. Interi është duke u përpjetë të nënshkruajë një kontratë të re sa më shpejt që të jetë e mundur, duke larguar pretendentët ose të paktën duke rritur klauzolën e lirimit. Është raportuar se oferta në tavolinë është një rrogë me vlerë 7.5 milionë euro në vit, e cila mund të shkojë deri në tetë milionë euro në vit. Por, Ikardi dhe përfaqësuesit e tij thuhet se po kërkojnë 10 milionë euro plus bonuse në vit.



Babai i Neymar shpërthen pas kritikave ndaj djalit të tij

Nejmar Sr. ka marrë në mbrojtje nga kritikët djalin e tij, pasi ylli i PSZH-së nuk arriti të përmbushë pritshmëritë në Ligën e Kampioneve, kundër Real Madridit. Sipas babait të tij, Neymar është i shqetësuar nga njerëz, të cilët janë të prirë ta shohin atë të bjerë, duke i krahasuar kritikët e tij me "grabitqarë". E ka bërë këtë përmes një shpërthimi të gjatë në mediat sociale. "Në një luftë ka nga ata që ushqehen me fitore dhe ka nga ata që, si grabitqarë, ushqehen nga hidhërimi i të humburit", – shkruan Nejmar Sr, i cili, gjithashtu, vepron si agjenti i lojtarit. "Ata nuk bëjnë asgjë, nuk prodhojnë asgjë, nuk jetojnë në qendër të vëmendjes. Në botën e futbollit ne i njohim këta njerëz si "sjellje të shpendëve". Ndonjëherë përfitojnë nga një mikrofon me zë të lartë, një karrierë mediokre e "të luajturit" (nuk është e drejtë të thërrasësh ata që, të paktën veprojnë në mënyrë të diskutueshme jashtë fushës me sportistët), gjithnjë nën hijen e të tjerëve, që janë



më të talentuar, për të çrrënjësuar frustrimet e tyre. Ata përfitojnë nga një humbje, një betejë e humbur, për të filluar gjuetinë, duke pritur humbjen në luftë, për të ushqyer egot e tyre, ashtu si kurvarët ushqehen me kërcime. Ata kurrë nuk do të fitojnë një Olimpiadë në Rio, por aty janë, duke pritur shansin e parë për të treguar shpirtat e tyre të ftohtë. Por, mbani mend: Kemi humbur një betejë, jo luftën. Lufta e djalit tim ka vazhduar që kur ai ishte një fëmijë, duke luftuar gjithmonë, duke u rilindur gjithnjë e më shumë!

Dhe mbi të gjitha, duke i respektuar të gjithë. Kemi humbur një betejë, ndoshta jo luftën. Dhe të jetë i sigurt për këtë... si një feniks, ai do të rilindë, gati për çfarëdo betejë që shtrihet përpara! Sa për ju, kopenë, do të jeni të uritur. Dhe nuk do të mbetet asgjë për të gëlltitur fjalët tua të kalbura", shkroi babai i Neymar. Ndërkohë, Neymar dhe PSZH-ja do të kenë rastin e tyre për përmbysje më 6 mars, kur e mirëpresin Real Madridin në "Parc des Princes" për pjesën e dytë të raundit 1/8 finale të Çampionit.

Mesfushori 24-vjeçar është vetëm në vitin e dytë të kontratës pesëvjeçare me Mançester Junajted, klub i cili nuk ka ndërmend të shesë. Dhe nëse ky qëndrim ndryshon në "Old Trafford", spanjollët duhet të ofrojnë më shumë se 120 milionë euro. Shumë do të varet nga lojtari, i cili, herë pas here, ka bërë figurë të pakënaquri në këtë sezon

Real Madridi dëshiron t'i japë fund qëndrimit të Pol Pogba në "Old Trafford", duke i ofruar Mançester Junajtedit më shumë se 120 milionë euro për mesfushorin, sipas "The Sun". 24-vjeçari u rikthye te "Djajtë e Kuq" në vitin 2016 për një rekord botëror prej 105 milionë eurosh, por nuk e ka gjetur formën e tij maksimale, ka marrë kritika dhe është "hedhur" nga Hoze Murinjo në javët e fundit. Real Madridi, që po ashtu, nuk ka qenë në lartësinë e duhur këtë sezon, e sheh francezin si një njeri që mund ta ndihmojë të kthehet në krye të La Ligas. Për këtë, bosët e

"BOMBA" VJEN NGA ANGLIA

REALI OFRON 120 MILIONË EURO PËR POGBAN

"Bernabeut" po planifikojnë një ofertë të guximshme për Pogba, që ta vënë në zbatim sapo të mbyllet sezoni. Mesfushori 24-vjeçar është vetëm në vitin e dytë të kontratës pesëvjeçare me Mançester Junajted, klub i cili nuk ka ndërmend të shesë. Dhe nëse ky qëndrim ndryshon në "Old Trafford", spanjollët duhet të ofrojnë më shumë se 120 milionë euro. Shumë do të varet nga lojtari, i cili, herë pas here, ka bërë figurë të pakënaquri në këtë sezon. Francezi u "asgjësua" gjatë

humbjes kundër Totenhemit, në fund të muajit të kaluar, dhe "ra" për lojën me Hadersfeld. Ai u "injurua" përsëri, kundër Njukasëll. Publikisht, Murinjo e ka mbështetur superstarin francez, duke lavdëruar qëndrimin e tij profesional. Pogba fitoi dy trofe në sezonin e tij të parë te Mançester Junajtedin, pas largimit nga Juventus.



Publicitet

Interi planifikon transferimin e Lamelas

Erik Lamela mund të rikthehet në kampionatin italian Serie A. Sulmuesi i talentuar argjentinas është rikthyer nga një lëndim i gjatë që e mbajti jashtë fushave. Argjentinasi ka zhvilluar 18 ndeshje këtë edicion me Totenhem ku ka shënuar një gol dhe ka bërë tre asistime. Është skuadra italiane Inter që po kërkon ta rikthejë argjentinasin në kampionatin italian Serie A. Sipas të përditshmes italiane "Tuttosport" trajneri i Interit, Luçiano Spaleti e pëlqen shumë lojën e argjentinasit dhe po e kërkon në klub. Gjithashtu edhe drejtori sportiv i klubit, Valter Sabatini po kërkon të këtë përsëri në skuadër Lamelan. Sabatini e kishte transferuar Lamelan në Romë nga skuadra argjentinase River Plate. E për të ardhur deri te transferimi i sulmuesit anësorë, Interi duhet të paguajë rreth 25 milionë euro.



Surfo dyfish më shumë për çmim të njëjtë

Pako javore me **2GB** internet për vetëm **99 den.** me Vip Pripejd

Mos e lësho telefonin, tani në duar ke dyfish më shumë internet! Aktivizo pakon javore me 2GB internet të përfshirë për vetëm 99 den. dhe surfo, pëlqe dhe gjithmonë qëndro onlajn me miqtë e tu për një argëtim onlajn të paharrueshëm. Për aktivizim dërgo SMS mesazh falas me tekst PROMO në 1410. Oferta është dispozicion një periudhë të kufizuar promotive.

Për më shumë informata vizito faqen tonë të internetit www.vip.mk ose telefono në Kontakt qendrën në 1234.



Më tepër për ju **vip**

